

FONDACIONI

*Qendër
Stambor*

OPEN BALKAN:

Përfitimet dhe Risqet

Qershor 2022

Studimi "Open Balkan: Përfitimet dhe Risqet" është përgatitur me mbështetjen e WFD - Westminster Foundation for Democracy.

Përmbajtja e këtij raporti është përgjegjësi e autorëve dhe nuk përfaqëson detyrimisht pikëpamjet e Fondacionit Qemal Stafa. Fondacioni ka të drejtat e plota të këtij raporti, i cili nuk mund të riprodhohet ose përkthehet i gjithë ose një pjesë e tij pa konfirmim paraprak.

Ekspertët:

Fatian Devija

Loredana Sulejmani

Qershor 2022

Tabela e Përmbajtjes

1. Iniciativa Open Balkan.....	1
2. Historiku i Integritit Rajonal	3
3. Open Balkan dhe Ngjashmëria me Inicativat Ekzistuese.....	5
4. Qëndrimet e Shteteve të Rajonit dhe Partnerëve në Lidhje me Open Balkan.....	8
5. Situata Ekonomike e Rajonit dhe Vendeve të Ballkanit Perëndimor	10
6. Përfitimet dhe Risqet e Nismës Open Balkan	16
6.1 Analiza SWOT.....	20
6.2 Analiza PESTEL.....	21
7. Gjetjet Kryesore	25
Referenca	26

Lista e Akronimeve

BP	Ballkani Perëndimor
BP6	Gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor
BE	Bashkimi Evropian
REA	Zona Ekonomike Rajonale
CRM	Tregu i Perbashket Rajonal
SPSEE	Pakti i Stabilitetit për Evropën Juglindore
CEFTA	Marrëveshja e Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore
SEEC	Procesit të Bashkëpunimit të Evropës Juglindore
RCC	Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal
IHD	Investime të Huaja Direkte
SHBA	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
UNCTAD	United Nation Center for Trade and Development
UNWTO	United Nation World Tourism Organization
TVSH	Tatimi mbi Vlerën e Shtuar

1. Iniciativa Open Balkan

Dy shtyllat kryesore të stabilitetit në Ballkanin Perëndimor janë integrimi në institucionet euroatlantike dhe bashkëpunimi rajonal. Nuk do të ishte ekzagjerim të thuhet se fal këtyre faktorëve kyç Ballkani Perëndimor aktualisht është më i qëndrueshme politikisht dhe në aspektin e sigurisë. Për më tepër, bashkëpunimi rajonal ka qënë dhe vazhdon të jetë një mjet për vlerësimin e gjashtë vendeve të Ballkani Perëndimor (BP6) jo vetëm për rrugën e tyre drejt integritimit në Bashkimin Evropian (BE) por edhe për integrimi rajonal ekonomik ndërmjet vendeve fqinje. Prosperiteti ekonomik i rajonit të Ballkanit Perëndimor është i paimagjinueshëm pa marrëdhënie të mira fqinjësore dhe bashkëpunim rajonal. Megjithatë, konfliktet e pazgjidhura dhe mosmarrëveshjet dypalëshe kanë çuar në mosbesim të konsiderueshëm në rajon, i cili ndonjëherë është burim jostabiliteti, duke minuar bashkëpunimin dhe përparimin në nismat rajonale. Iniciativat e shumta rajonale që janë krijuar deri më tani për gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor dhe që vazhdojnë të krijohen janë kryesisht të pazbatuara për shkak të mungesës së marrëdhënieve dypalëshe, mungesës së kapaciteteve dhe mosbesimit të trashëguar nga e kaluara. Për më tepër, një pjesë e qeverive të vendeve të Ballkanit Perëndimor vështirë se e trajtojnë bashkëpunimin rajonal si një prioritet politik. Nëse këto probleme do të vazhdojnë të persistojnë midis BP6, do të jetë sfiduese për të arritur integrimin e duhur ekonomik rajonal dhe me këtë edhe integrimin në BE.

Ballkani Perëndimor do të duhet të punojë në shumë fronte, duke përfshirë zgjidhjen e çështjeve dypalëshe dhe përmirësimin e marrëdhënieve me njëri-tjetrin, si parakusht kryesor për përparim në bashkëpunimin rajonal. Përveç kësaj, kapacitetet zbatuese do të duhet të përmirësohen dhe bashkëpunimi rajonal do të duhet të jetë më i lartë në axhendën e politikave për qeveritë e vendeve të Ballkanit Perëndimor.

Forma më e re e bashkëpunimit rajonal është “Ballkani i Hapur” ose referuar shpesh me termin “Open Balkan”. Open Balkan është një zonë e përbashkët ekonomike dhe politike e tre shteteve anëtare të Ballkanit Perëndimor, duke përfshirë Shqipërinë, Maqedoninë e Veriut dhe Serbinë. Vendet e tjera të BP6 janë ftuar t’i bashkohen kësaj iniciative por momentalisht ato e kanë refuzuar pjesëmarrjen duke parashtruar argumente të ndryshme. Vendet anëtare synojnë të rrisin tregtinë dhe bashkëpunimin si dhe të përmirësojnë marrëdhëniet dypalëshe midis tyre. Deri në këto momente, një numër i konsiderueshëm marrëveshjesh bashkëpunimi janë firmosur të cilat sjellin implikime në jetën politike dhe ekonomike të vendeve përkatëse. Rëndësia e bashkëpunimit rajonal theksohet nga dy përfitime kryesore. Së pari, ai redukton tensionin dhe forcon stabilitetin rajonal, i cili nga ana tjetër është një parakusht kryesor për zhvillimin e qëndrueshëm. Dhe së dyti, sjell përfitime të ndryshme praktike. Këto të fundit rrjedhin nga rritja e flukseve ndërrajonale të mallrave dhe shërbimeve, si dhe nga shkëmbimet shken

core dhe kulturore, rritja e konkurrencës së ekonomive relativisht të vogla kombëtare dhe rritja e atraktivitetit të rajonit në tërësi si destinacion investimi. Sfidat kryesore ekonomike dhe sociale të rajonit si përmirësimi i infrastrukturës, diversifikimi i furnizimeve të qëndrueshme të energjisë, forcimi konkurrueshmërisë, rritja e eksporteve, reduktimi i niveleve të larta të pap-

unësisë, zhvillimi i kapaciteteve administrative, adresimi i problemeve mjedisore, lufta kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, dhe përmirësimi i mjedisit të biznesit janë të zakonshme për vendet e Ballkanit Perëndimor por, më e rëndësishmja, mund të adresohen në mënyrë më efektive me përpjekje të përbashkëta dhe të koordinuara në nivel rajonal.


2. Historiku i Integritit Rajonal

Shumë nisma rajonale janë ndërmarrë në Ballkanin Perëndimor gjatë viteve të fundit dhe nisma të reja vazhdojnë të shfaqen çdo disa vjet. Megjithatë, strukturat e tyre mbeten të dobëta, të pambrojtura ndaj goditjeve politike dhe konflikteve rajonale të herëpashershme, dhe për më tepër ato sjellin ndryshime shumë të kufizuara në bashkëpunimin rajonal dhe përfitime për qytetarët e të gjitha vendeve. Ndër iniciativat e shumta rajonale, më të debatuarat kanë qenë: Zona Ekonomike Rajonale (REA), “Mini-Shengen” i cili më pas morri emrin “Open Balkan”, dhe së fundmi Tregu i Përbashkët Rajonal (CRM). Shpërbërja e Jugosllavisë solli një valë iniciativash që duhej të përcaktonin një sistem të ri marrëdhëniesh në të gjithë Ballkanin Perëndimor. Bashkimi Evropian u përpoq t'i qartësonte këto marrëdhënie përmes një “qasjeje rajonale”. U krijua si rrjedhojë Pakti i Stabilitetit për Evropën Juglindore (SPSEE) në vitin 1999 për “të nxitur paqen, demokracinë, respektimin e të drejtave të njeriut dhe prosperitetin ekonomik” për stabilitetin në rajon. Një sërë projektsh rajonale u iniciuan menjëherë më pas, nën ombrellën e Paktit të Stabilitetit të udhëhequr nga BE-ja për Evropën Juglindore. Një Memorandum Mirëkuptimi për liberalizimin e tregtisë u miratua nga ministrat e tregtisë së jashtme të tetë vendeve të Evropës Juglindore në qershor 2001 në Bruksel, duke çuar në nënshkrimin e marrëveshjeve dypalëshe të tregtisë së lirë që parashikonin eliminimin progresiv të të gjitha barrierave tregtare. Për të harmonizuar rregulloret e tregtisë, këto marrëveshje dypalëshe

të tregtisë së lirë u shndërruan në një marrëveshje shumëpalëshe në vitin 2006 – Marrëveshja e Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore 2006 (CEFTA 2006). Këto marrëveshje mundësonin liberalizimin e plotë të tregtisë si në prodhimet industriale ashtu edhe në ato bujqësore (CEFTA, 2022).

Megjithëse koncepti i “rajonalizmit të ri” u përhap mjaft vonë në Ballkanin Perëndimor për shkak të këtyre ngjarjeve fatkeqe u kompensua shpejt me mbi 40 nisma rajonale të nisura në dekadat e fundit. Fillimisht, bashkëpunimi rajonal u perceptua kryesisht si një strategji paqeje dhe forcimi i sigurisë në rajon. Kjo u arrit përmes formatit të Procesit të Bashkëpunimit të Evropës Juglindore (SEEC), duke përfshirë një grup vendesh përtej kufijve gjeografikë të Ballkanit Perëndimor. Në vitin 2008, Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal (RCC) u krijua si pasues i Paktit të Stabilitetit dhe organi operacional i Procesit të Bashkëpunimit të Evropës Juglindore (SEEC) për të rritur pronësinë rajonale (ERBD, 2018).

Me zbehjen e premtimit për anëtarësimin në BE për Ballkanin Perëndimor pas manifestimit të “lodhjes së zgjerimit” të BE-së, kancelarja gjermane Angela Merkel dhe ministri i jashtëm gjerman Frank-Walter Steinmeier nisën Procesin e Berlinit në vitin 2014. Kjo nismë evropiane e udhëhequr nga Gjermania u përpoq të ringjallte perspektivën e BE-së në rajoni duke lehtësuar bashkëpunimin

Figura 1: Historiku i nismave rajonale në rajonin e Ballkanit Perëndimor**Burimi:** Përpunim i autorëve

rajonat ndërmjet gjashtë vendeve të Ballkanit Perëndimor – Shqipëria, Bosnja-Hercegovina, Kosova, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi dhe Serbia – dhe t’i ndihmonte ata të përmbushin kriteret e anëtarësimit në Bashkimin Evropian. Në praktikë, Axhenda e Procesit të Berlinit është një ombrellë gjithëpërfshirëse që bashkon mekanizma të shumtë për të forcuar bashkëpunimin dhe zhvillimin ekonomik në BP6. Kjo mundësoi bashkëpunim të gjerë rajonal në Ballkanin Perëndimor përmes formatit të ri të “Ballkanit Perëndimor 6”. Si pjesë e Procesit të Berlinit, në korrik 2017, Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal (RCC) prezantoi Planin Shumëvjeçar të Veprimit për një Zonë Ekonomike Rajonale në Ballkanin Perëndimor (MAP REA) gjatë Samitit të Procesit të Berlinit në Trieste, Itali. Dy vjet më pas, nisma u kritikua për progres të pamjaftueshëm që mund të formësohej në rritje ekonomike dhe integrim të mëtejshëm (BPRG, 2021).

Paralelisht, në tetor 2019, presidenti serb Aleksandar Vuçiq, kryeministri shqiptar Edi Rama

dhe kryeministri i Maqedonisë së Veriut Zoran Zaev nisën të ashtuquajturin “Mini-Shengen” me synimin për të çuar më tej integrimin ekonomik ndërmjet tyre përmes lëvizjes së lirë të njerëzve, mallrave, shërbimeve, dhe kapitalit duke përdorur vetëm kartat e identitetit. Më tej, pas Zonës Ekonomike Rajonale dhe “Mini-Shengen”, një tjetër nismë rajonale ka nisur. Në nëntor 2020, në Samitin e Procesit të Berlinit në Sofje, Bullgari, RCC prezantoi Tregun e Përbashkët Rajonal iniciativën më të re rajonale, të ndërtuar mbi REA, me qëllim krijimin e një tregu rajonal bazuar në rregullat dhe procedurat e BE-së dhe sjelljen e rajonit më afër tregut të vetëm të BE-së. Integrimi ekonomik rajonal i bazuar në rregullat e BE-së dhe shoqërimi më i afërt me Tregun Unik të BE-së do të ndihmojë Ballkanin Perëndimor në procesin e anëtarësimit. Në të njëjtën kohë, procesi i anëtarësimit dhe përputhja graduale me kuadrin ligjor të BE-së do të ndihmojë në forcimin e integritit ndërrajonal (BiEPAG, 2021).

3. Open Balkan dhe Ngjashmëria me Iniciativat Ekzistuese

Më 10 tetor 2019, në Novi Sad, Serbi, filloi një proces të ri paralel pasi presidenti serb Aleksandar Vuçiq, kryeministri shqiptar Edi Rama dhe kryeministri i Maqedonisë së Veriut Zoran Zaev shpallën të ashtuquajturën nismë “Mini-Shengen” që kërkon të krijojë lëvizjen e lirë të njerëzve, mallrave, shërbimeve dhe kapitalit në Ballkanin Perëndimor duke përdorur vetëm kartat e identitetit. Takime të mëtejshme u mbajtën më 10 nëntor 2019 në Ohër, Maqedonia e Veriut dhe më 21 dhjetor 2019 në Tiranë, Shqipëri për të diskutuar propozimet për arritjen e “katër lirive” duke përfshirë miratimin e një marrëveshjeje kuadër për emergjencat civile të njohur si “Protokolli i Durrësit”.

Në Forumin Ekonomik për Bashkëpunimin Rajonal të mbajtur në Shkup më 29 qershor 2021, liderët e Shqipërisë, Maqedonisë së Veriut dhe Serbisë shpалosën emrin e ri për atë që njihet deri në ato momente si nisma Mini-Shengen. Zyrtarisht nisma tani ka marrë emrin “Ballkani i Hapur” ose si njihet gjerësisht “Open Balkan”. Treshja nënshkroi një marrëveshje ndërshtetërore dhe dy Memorandume Mirëkuptimi, duke thelluar lidhjet politike dhe ekonomike midis këtyre vendeve. Në këtë forum u ngritën pyetje mbi ngjashmërië e kësaj nisme me nismat e tjera ekzistuese dhe veçanërisht me atë të Tregut të Përbashkët Rajonal, me pjesën tjetër të vendeve të Ballkanit Perëndimor që mbeten skeptike dhe vendosën të mos marrin pjesë (Ristic, D., 2021).

Krahas nënshkrimit të një Marrëveshjeje për Bashkëpunim në rast katastrofe dhe një Memorandumi të përcaktuar për lehtësimin e lëvizjes

së lirë të mallrave, propozimi më i rëndësishëm që del nga nisma e Ballkanit të Hapur është krijimi i aksesit të lirë në tregun e punës në rajon. Një marrëveshje ndërshtetërore, që shënon zbatimin e aksesit të lirë në tregun rajonal të punës, u nënshkrua në Beograd në fillim të nëntorit 2021. Për më tepër, më shumë se dy vite e gjysmë pasi ideja u prezantua për herë të parë, treshja ka treguar një përkushtim të qartë drejt arritjes së një zone të lëvizjes së lirë si Shengen. Në samitin e Shkupit, ata shpallën një agjendë ambicioze që do të sillte shfuqizimin e plotë të kontrolleve. Në kuadër të nismës Open Balkan, deri më tani janë ndërmarrë hapat e mëposhtëm:

- Memorandum për Lëvizjen e Lirë të njerëzve që përdorin vetëm letërnjoftime dhe unifikimin e procedurave për dhënien e lejeve të punës për të gjithë qytetarët në vendet e Ballkanit Perëndimor;
- 24- orë funksionimi i kontrolleve kufitare për kontrollet fitosanitare dhe veterinare;
- Përfunduan negociatat ndërmjet Maqedonisë së Veriut dhe Serbisë për ndërtimin e pikës së re kufitare Lojanë – Miratovac;
- Marrëveshja ndërmjet administratave doganore të Maqedonisë së Veriut dhe Shqipërisë për një sportel me një ndalesë në pikën kufitare Kjafasan dhe me Serbinë në pikën kufitare Tabanovca me qëllim që të bëhet Non-Stop-Shop (kalime kufitare pa ndalesa);
- Bashkëpunimi rajonal për katastrofat natyrore, duke lejuar të tre vendet të bashkëpunojnë ngushtë jo vetëm në parandalimin, por edhe në dhënien dhe koordinimin e ndihmës reciproke gjatë tërmeteve, stuhive, zjarreve dhe fatkeqësive të tjera;

- Futja e një sistemi pa letra për të thjeshtuar procedurat doganore (BPRG, 2021);
- Adresimi i evazionit fiskal;
- Njohja e diplomave universitare;
- Bashkëpunimi kulturor;
- Bashkëpunimi ndërkufitar në sektorin e turizmit duke përfshirë një propozim për të krijuar një hartë turistike të përbashkët të Ballkanit të Hapur (Samiti i Ohrit, 2022).

Nisma e Open Balkan bazohet në një nivel tashmë të arritur bashkëpunimi dhe besimi rajonal të krijuar me zbatimin e nismave ekzistuese rajonale por ofron një kontribut thelbësor për integrimin e mëtejshëm rajonal. Për të kuptuar më mirë vlerën e shtuar që sjellë kjo iniciativë do të duhet të vendoset përballë nismave rajonale më të rëndësishme dhe të debatuar në 5 vjeçarin e fundit.

Të tre iniciativat rajonale – Zona Ekonomike Rajonale, Open Balkan dhe Tregu i Përbashkët Rajonal, në një mënyrë ose në një tjetër, synojnë të përsërisin “katër liritë” e Bashkimit Evropian në Ballkanin Perëndimor duke ndryshuar në formë dhe në substancë. Megjithatë, ndryshe nga Open Balkan, Tregu i Përbashkët Rajonal dhe Zona Ekonomike Rajonale janë në thelb të lidhura me njëra-tjetrën duke u konsideruar si pjesë integrale dhe disa masa të së parës bazohen në ato të së dytës.

Të tre nismat synojnë të sigurojnë qarkullimin e lirë të mallrave, shërbimeve, investimeve dhe njerëzve të kualifikuar brenda rajonit pa tarifa, kuota apo barriera të tjera të panevojshme. Në këtë drejtim, Open Balkan synon ta lehtësojë këtë duke përdorur kartat e identitetit, koncept i cili është adoptuar edhe nga Tregu i Përbashkët Rajonal. Në këtë koncept, Open Balkan ka përparësinë se do të sigurojë lëvizjen e lirë brenda rajonit pa tarifa, kuota apo barriera të tjera të panevojshme për të gjitha produktet dhe të gjithë punëkërkuessit të të gjithë profesionëve. Lëvizja e lirë e fuqisë punëtore nën kuadrin e CRM-së është me shtrirje të kufizuar, me heqjen e lejeve të punës vetëm për transferimet ndërmjet kompanive dhe ofruesëve të

veçantë të disa shërbimeve, nisma e Ballkanit të hapur shkon një hap më tej duke mundësuar punësimin e barabartë të të gjithë fuqisë punëtore të rajonit duke u mjaftuar vetëm me një leje pune. Ndërkohë që CRM parashikon kohë të reduktuar të pritjes në kufi për mallrat dhe qytetarët që udhëtonin me asgjë më shumë se kartat e identitetit, nisma e Open Balkan do të shfuqizojë plotësisht kontrollet kufitare, pra, duke reduktuar kohën e pritjes në zero, si për qytetarët ashtu edhe për tregtinë (Komisioni Evropian, CRM 2021).

Aktualisht, vetëm REA përfshin masa specifike për tërheqjen e Investimeve të Huaja Direkte (IHD). Si pasardhës i REA, Tregu i Përbashkët Rajonal bazohet mbi këtë duke kërkuar të harmonizojë politikat e investimeve me standartet e BE-së dhe të krijojë një Zonë Rajonale Investimi. Ndërsa Open Balkan për shkak edhe se është krijuar në një moment të mëvonshëm ende nuk ka një plan specifik për IHD në rajon por objektivat janë të qarta. Vetë thelbi i kësaj nisme është të zgjerohen ekonomitë dhe tregjet e BP6 të cilat janë ende të vogla në vetvete, por nëse integrohen me njëri-tjetrin, ato do të rriten për të përfaqësuar një treg të rëndësishëm, jo vetëm për aktorët lokal të tregut, por edhe për investimet e huaja direkte në këtë fushë. IHD-të kanë një kufi në lidhje me hapësirën e shfrytëzimit të tregut dhe për të tërhequr më shumë investime të huaja direkte dhe për të ndërtuar një treg që ofron punësim shumë më cilësor dhe ofron vlerë të shtuar, duhet të ofrohet një hapësirë më e gjerë tregtinë (Komisioni Evropian, REA 2021).

Në mënyrë të ngjashme, në integrimin dixhital, REA dukshëm përmirësoi infrastrukturën dixhitale të rajonit dhe lidhjen rajonale duke kulmuar me Marrëveshjen Rajonale të Roaming-ut, e cila eliminoi koston e shërbimeve roaming në rrjetet publike të komunikimit celular në rajonin e Ballkanit Perëndimor. Duke u zgjeruar mbi këtë, CRM synon të krijojë një Zonë Dixhitale Rajonale për të integruar Ballkanin Perëndimor në tregun dixhital pan-evropian. Iniciativa Open Balkan është më pak specifike në këtë fushë.

Figura 2: Ngjashmëritë midis nismave rajonale të rajonit të Ballkanit Perëndimor

	REA	Open Balkan	CRM
Tregtia	Lëvizja e lirë e mallrave, shërbimeve, investimeve dhe njerëzve të kualifikuar. Tregtia e lehtësuar më shumë se rregullat e Organizatës Botërore të Tregtisë-së, duke synuar njohjen e të gjitha dokumenteve kufitare, aty ku është e zbatueshme.	Fluksi i lirë i mallrave, shërbimeve, investimeve dhe njerëzve nëpërmjet kartave të ID-së, i lehtësuar nga funksionimi 24 orësh i kontrolleve kufitare për kontrollet fitosanitare dhe veterinare, dyqane me një ndalesë në kalimin kufitar me objektivin për t'u bërë Non-Stop Shop (kalime kufitare pa ndalesa) dhe një sistemi pa letra për të thjeshtuar procedurat doganore. Ndërtimi i pikës së re kufitare	Lëvizja e lirë e mallrave, shërbimeve, kapitalit dhe njerëzve nëpërmjet Korridoretve të Gjelbërta.
Investimet	N/A	Llojane – Miratovac ndërmjet Maqedonisë së Veriut dhe Serbisë.	N/A
Lëvizshmëria	Heqja e pengesave në lëvizjen e studentëve, studiuesve dhe profesionistëve në sektorë me interes (Doktorë të Mjekësisë, Stomatologë, Arkitektë dhe Inxhinierë Ndërtimi) përmes standardeve dhe procedurave të përbashkëta për njohjen automatike të kualifikimeve akademike.	Lëvizja e lirë e njerëzve duke përdorur vetëm karta identiteti dhe unifikimi i diplomave univeritare dhe i procedurave për dhënien e lejeve të punës për të gjithë qytetarët në vendet e Ballkanit Perëndimor.	Lëvizja e lirë e njerëzve duke përdorur karta identiteti dhe njohjen reciproke të kualifikimeve akademike dhe profesionale për profesione të caktuara.
Digjitalizimi	Zhvillimi i infrastrukturës dixhitale. Shërbim Roaming falas brenda vendeve të rajonit.	N/A	Shërbimi Roaming falas, siguri kibernetike e përmirësuar dhe mbrojtje të të dhënave.

Burimi: Komisioni Evropian, 2021

Nisma e Open Balkan ndan të njëjtat qëllime si REA dhe CRM por ofron një integrim më të thellë ndërrajonal nëpërmjet rritjes së nivelit të lidhjeve ekonomike dhe shoqërore midis vendeve në këtë fazë fillestare. Përparësia e kësaj nisme qëndron në faktin se ajo është një nismë rajo-

nale e përbashkët dhe hapat e integritit rajonal mund të vendosen bashkërisht midis vendeve dhe mundësi që paraqiten pa qënë të detyruar të presin një axhendë nga institucionet euro-atlantike.

4. Qëndrimet e Shteteve të Rajonit dhe Partnerëve në Lidhje me Open Balkan

Open Balkan është një zonë e përbashkët ekonomike dhe politike e tre shteteve anëtare në Ballkan, duke përfshirë Shqipërinë, Maqedoninë e Veriut dhe Serbinë. Vendet e tjera të BP6 janë ftuar t'i bashkohen kësaj iniciative por momentalisht ato e kanë refuzuar pjesëmarrjen duke parashtruar argumente të ndryshme. Më 4 shtator 2020, Kosova pranoi t'i bashkohet Zonës Mini-Shengen si pjesë e marrëveshjeve të normalizimit ekonomik të Kosovës dhe Serbisë, por deri më tani nuk ka nënshkruar asnjë marrëveshje me tre shtete themeluese, madje duke e kundërshtuar të gjithë iniciativën. Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka refuzuar së fundmi dhe ftesën për Samitin në Ohër, i cili u mbajt më 7-8 qershor të këtij viti. Kurti u shpreh se iniciativa e Open Balkan është një iniciativë e dëmshme rajonale pa vizion. Kosova nuk dëshiron të bashkohet sepse Serbia nuk po e trajton atë si palë të barabarta dhe të pavarur (Balkan Insight, 2022).

Kryeministri i Malit të Zi Dritan Abazović u shpreh së fundmi duke marr pjesë edhe në Samitin e Ohrit se mbështet iniciativën e Open Balkan duke thënë se kjo iniciativë i takon dhe është bërë për gjashtë vende të rajonit duke inkurjuar dhe vendet e tjera të konsiderojnë përfshirjen e tyre në këtë iniciativë. Por në të njëjtën kohë, presidenti i Malit të Zi Milo Dukanović është kundër iniciativës duke thënë se Open Balkan u nis në një "moment depressioni" për shkak të largimit të pritshëm të kancelares gjermane Angela Merkel dhe refuzimit të BE-së për të avancuar ofertat e anëtarë

simi të vendeve të Ballkanit duke harruar se integrimi rajonal nuk është një pikë në destinacionin e anëtarësimit në BE por një proces dhe rrugëtim i cili do të vazhdojë po njësoj ndoshta dhe më i fortë edhe pas anëtarësimit të gjashtë vendeve (Kajosevic, S., 2022).

Kryetari i Këshillit të Ministrave të Bosnje-Hercegovinës Zoran Tegeltija shprehu mbështetjen personale për iniciativën, por Bosnje-Hercegovinës ende i mungon një konsensus në nivel kombëtar për "arsye politike". Në samitin e Ohrit, Tegeltija mori pjesë si vëzhgues por ofroi pak optimizëm rreth mundësisë që vendi i tij t'i bashkohej nismës. Kjo është hera e parë që një samit i nismës ka tërhequr pesë përfaqësues nga gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor, gjë që shihet si përparim i konsiderueshëm (Samiti i Ohrit, 2022).

Komisioneri Evropian për Fqinjësi dhe Zgjerim, Olivér Várhelyi, përshëndeti Samitin e Open Balkan më 8 qershor në Ohër, të organizuar nga kryeministri i Maqedonisë së Veriut, Dimitar Kovachevski. Përpara Samitit, komisioneri Várhelyi u shpreh në favor të nismës: "Unë mirëpres shtysën e liderëve të Ballkanit Perëndimor për të avancuar në integrimin rajonal. Lufta që Rusia ka bërë në Evropë është një thirrje zgjimi për nevojën për të përshpejtuar procesin e anëtarësimit në BE, një investim gjeostrategjik në stabilitetin dhe sigurinë e të gjithë Evropës. Bashkëpunimi rajonal gjithëpërfshirës, i bazuar në rregullat e BE-së, është kyç për të afruar Ballkanin Perëndimor me tregun e vetëm të BE-së, i cili është në qendër të prosperitetit tonë të përbashkët" (Komisioni Evropian, 2022).

I dërguari i posaçëm i Shteteve të Bashkuara të Amerikës (SHBA) për Ballkanin Perëndimor, Gabriel Escobar, iu drejtua Samitit përmes video-lidhjes duke thënë se Shtetet e Bashkuara e mbështesin Open Balkan përsa kohë nisma është në favor të bashkëpunimit dhe integritimit në strukturën evropiane. “Bashkëpunimi ndërkuftar në Ballkanin Perëndimor duhet të synojë një integritet më të madh evropian” u shpreh Escobar. Në fjalimin e tij ai e quajti Open Balkan një “iniciativë të madhe”, por tha gjithashtu se donte të shihte më shumë qartësi se si supozohet të funksionojë në vijim (European Western Balkans, 2022).

Figura të njohura të politikës, shoqërisë civile përfshirë përfaqësues të organizatave rinore në rajon dhe në Bashkimin Europian janë shprehur në favor të integritimit të shtuar ndërrajonal dhe të nismës së ndërmarrë nga tre vendet e Ballkanit Perëndimor. Në vijim të punimeve për Kongresin e Partisë Socialiste të Shqipërisë, Fondacioni “Qemal Stafa” mbajti në Tiranë në 8 prill “Forumit e Ballkanit Perëndimor 2030”. Përgjatë forumit, Z. Knut Fleckenstein – Anëtar i Partisë Social-Demokrate në Gjermani përshëndeti punën e bërë nga vendet e Ballkanit Perëndimor dhe vlerësoi integritimin ndërrajonal të shtuar shkak i nismave të marra. Homologu i tij suedez Z. Adnan Dibra – Anëtar i Partisë Social-Demokrate theksoi gjithashtu rëndësinë e bashkimit të rajonit si një i tërë në prosperitetin ekonomik dhe fuqinë negociuese për bisedat e mëtejshme me institucionet evropiane. Përfaqësues të organizatave të ndryshme pjesëmarrëse u përqendruan në bashkëpunimin dhe prosperitetin e mëtejshëm të gjashtë vendeve

anëtare të Ballkanit Perëndimor. Aty ku ende nuk është shfaqur apo përpunuar ndonjë qëndrim i përbashkët për të ardhmen e paparashkuar, është e rëndësishme të diskutohet dhe të ndërmerren hapa për t’i rezistuar sfidave aktuale, me prioritete të qarta me të cilat mund të arrihen qëllimet e zhvillimit të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës (Fondacioni Qemal Stafa, 2022). Në 3-4 qershor një përfaqësi e të rinjve të rajonit dhe figurave të njohura politike morrën pjesë në tryezën e rrumbullakët të organizuar në Tiranë nga Fondacioni “Qemal Stafa” ku sekretari i përgjithshëm i Partisë Socialiste të Shqipërisë, Damian Gjoknuri, konfirmoi vullnetin për të cuar përpara nismën e Open Balkan dhe integritimin rajonal. Ndërkohë Tanja Fajon – Anëtare e Parlamentit në Slloveni, u ndal në procesin e ngadaltë të anëtarësimit në BE dhe vlerësoi përpjekjet individuale dhe rajonale për të ecur përpara në rrugën e zhvillimit dhe integritimit ndërrajonal. Përsa i përket Shqipërisë, rezultatet e Këshillimit Kombëtar¹ tregojnë që 59% e shqiptarëve mbështesin nismën e Ballkanit të Hapur, duke vërtetuar që kjo mbështetje shkon përtej përkatësive politike. Sipas ministres Xhaçka ka dy arsye kryesore përse qeveria po punon fort për Open Balkan. Në njërin anë, kjo nismë është një mekanizëm që zbaton e bën më efikase proceset e parashikuara në Procesin e Berlinit duke ju dhënë atyre pronësi lokale. Në dyti, dimensionin strategjik i kësaj nisme e cila në fakt, ashtu si Procesi i Berlinit, ngrihet mbi filozofinë që zgjidhja e problemeve që ka ende sot rajoni, kalon nga bashkëpunimi e integritimi” (Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, 2022).

¹ Mbi 500 mijë shtetas shqiptarë u bënë pjesë e pyetësorit të Këshillimit Kombëtar, duke dhënë mendimin e tyre për disa prej çështjeve më të rëndësishme që prekin vendin.

5. Situata Ekonomike e Rajonit dhe Vendeve të Ballkanit Perëndimor

Ballkani Perëndimor ka bërë një rrugë të gjatë në dy dekadave të fundit. Popullsia aktuale e Ballkanit Perëndimor është rreth 17.6 milionë banorë. Sot, gjashtë ekonomitë (Shqipëria, Bosnja-Hercegovina, Kosova, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut dhe Serbia) kanë një produkt të brendshëm

bruto të kombinuar (PBB) prej afër 309 miliardë dollarësh nga 106 miliardë në vitin 2000, që përfaqëson 1.5% të PBB-së së Bashkimit Evropian. PBB-ja mesatare për frymë e rajonit shënoi rreth 16 000 USD në 2021, duke u trefishuar nga 6 000 USD në 2000 (Banka Botërore, 2022).

Figura 3: Të dhëna të përgjithshme ekonomike për vendet dhe rajonin BP6, 2021

	Popullsia	Norma e papunësisë (në %)	PBB-ja për frymë (në USD)	Exportet (% e PBB-së)	Importet (% e PBB-së)	Balanca në llogarinë korrente (në % të PBB-së)	Flukset hyrëse neto të IHD-ve (në % të PBB-së)
Shqipëria	2 854 191	11.5	13 680	31.6	45.3	-8	7.9
Bosnja-Hercegovina	3 301 000	15.7	14 875	40.1	55.2	-3.1	1.9
Kosova	1 788 878	25.7	11 402	29.2	56.3	-5.6	3.6
Maqedonia e Veriut	2 083 459	15.1	21 534	43.7	64.8	-15.1	7.6
Mali i Zi	622 028	17.3	16 607	62.3	76.5	-3.3	4.4
Serbia	6 945 235	10.4	18 292	51	61	-6.9	8.3
BP6	17 594 791	15.9	16 065	43	59.9	-7	5.6

Burimi: Banka Botërore, 2022

Vendndodhja e rajonit dhe marrëdhëniet e thella me Evropën dhe shumë pjesë të botës paraqesin mundësi të shumta. Modele të ngjashme zhvillimi historik i kanë pajisur ekonomitë e rajonit me infrastrukturën relativisht solide, përvojën industriale dhe një bazë aftësishe dhe traditë akademike që mund të jenë leva të zhvillimit të ardhshëm. Ekonomitë e rajonit kanë marrëdhënie të thella me shumë pjesë të Evropës dhe botës si rezultat i flukseve të fundit migratore dhe shekujve të të qenit në udhëkryq të Evropës Juglindore. Meqenëse distanca gjeografike duket se zvogëlohet me dixhitalizimin, këto marrëdhënie mund të përdoren për zhvillim të

mëtejshëm dinamik. Në të njëjtën kohë, afërsia gjeografike me tregjet e rëndësishme evropiane dhe rrjetet e prodhimit ofron mundësi ekonomike, nëse mund të ofrohen aftësitë e duhura, infrastruktura dhe mjediset e biznesit. Integrimi i mëtejshëm në BE është një shtytës qendror i shumë prej mundësive të rajonit. Ekonomitë e Ballkanit Perëndimor pësuan një rikthim të fortë të rritjes në 2021 duke përfshirë një bazë të gjerë aktiviteteve. Në vitin 2021, sipas fig 4, rritja e PBB-së në Perëndim Ballkani arriti në 7.4 për qind pas një tkurrjeje prej 3.2 për qind në vitin 2020. Rritja u nxit nga një rikthim jashtëzakonisht i fortë në konsum,

duke kontribuar me 5.3 për qind në norma e rritjes së rajonit, e ndihmuar nga stimujt fiskalë dhe një relaksim në lëvizjet dhe rregullat Anti Covid-19. Ka pasur një rritje veçanërisht të fortë në tregtinë në 2021 pasi rajoni përfitoi nga një rimëkëmbje në kërkesën globale, por konflikti ndërmjet Rusisë dhe Ukrainës pritet të prishin këtë trend. Eksportet u rritën me 39.2 për qind

dhe importet me 29.0 për qind në vitin 2021.

Për më tepër ekonomitë e Ballkanit Perëndimor përfituan nga një rimëkëmbje e fortë dhe me bazë të gjerë në kërkesë për mallra dhe shërbime të rajonit. Si rezultat, deficitet e llogarisë korente u ngushtuan në shumë vende (Shqipëri, Bosnja-Hercegovina dhe Mali i Zi) (Banka Botërore, 2022).

Figura 4: Rritja e PBB-së reale të vendeve dhe rajonit BP6

Rritja e PBB-së reale	2019	2020	2021	2022*	2023*	2024*
Shqipëria	2.2	-3.5	8.5	3.2	3.5	3.5
Bosnja-Hercegovina	2.8	-3.1	7.1	2.7	3.1	3.5
Kosova	4.8	-5.3	9.1	3.9	4.3	4.2
Maqedonia e Veriut	3.9	-6.1	4	2.7	3.1	3.2
Mal i Zi	4.1	-15.3	12.4	3.6	4.7	3.7
Serbia	4.3	-0.9	7.4	3.2	2.7	2.8
BP6	3.7	-3.2	7.4	3.1	3.1	3.2


Burimi: Banka Botërore 2022, *parashikime

Prosperiteti ekonomik i rajonit të Ballkanit Perëndimor është i paimagjinueshëm pa marrëdhënie të mira fqinjësore dhe bashkëpunim rajonal. Rëndësia e bashkëpunimit rajonal theksohet nga dy përfitime kryesore. Së pari, ai redukton tensionin dhe forcon stabilitetin rajonal, i cili nga ana tjetër është një parakusht kryesor për zhvillimin e qëndrueshëm. Dhe së dyti, sjell përfitime të ndryshme praktike. Këto të fundit rrjedhin nga rritja e flukseve ndërrajonale të mallrave dhe shërbimeve, si dhe nga shkëmbimet shkencore dhe kulturore, rritja e konkurrencës së ekonomive relativisht të vogla kombëtare dhe rritja e atraktivitetit të rajonit në tërësi si destinacion investimi. Megjithatë, rajonalizimi dhe integrimi më i thellë i BP6 mund të kufizohet nga faktorë më objektivë, të tillë si potenciali i kufizuar për tregti brenda BP6, shpërndarja e pabarabartë e fitimeve dhe humbjeve pas integritit dhe mosmarrëveshjet në ndërtimin e strategjive për tërheqjen e IHD-ve.

Këto sfida mund t'i analizojmë duke llogaritur dhe vëzhguar tendencat në treguesit përkatës të integritit rajonal në lidhje me tregtinë ndërrajonale, strukturën e industrisë dhe IHD-të rajonale.

Sipas studimit të IPPM-së (2015), flukset tregtare midis BE-së dhe Ballkanit Perëndimor tregojnë asimetri të fortë. Për BP6, BE-ja mbetet partneri i vetëm tregtar më i rëndësishëm nga të gjithë. Megjithatë, varësia nga tregtia me BE-në ka ardhur duke u ulur në vitet 2000, së bashku me zhvillimin e rajonit. Në dekadën e fundit, treguar në fig 5, vihet re një varësi lehtësisht në rritje nga vendet e BE-së për eksportet/importet e BP6 në kurriz të tregtisë ndërrajonale brenda rajonit. Për BE-në, nga ana tjetër, Ballkani Perëndimor mbetet jo kaq i rëndësishëm, me më pak se 1% të importeve të përgjithshme të BE-së me origjinë nga rajoni dhe më pak se 2% e eksporteve të BE-së drejtë rajonit.

Figura 5: Tregtia ndërrajonale e rajonit të BP6 me vetveten, BE dhe vendet e tjera të botës




Burimi: The Observatory of Economic Complexity (OEC), 2022

Literatura teorike parashikon se ekonomitë e vogla që kanë struktura të ngjashme prodhimi gëzojnë përfitime të kufizuara nga integrimi i mëtejshëm rajonal (Geda, A., et al, 2008). Për të analizuar tendencat tregtare ndërrajonale të BP6, ne llogarisim pjesën e tregtisë ndërrajonale për çdo vend dhe për të gjithë BP6. Në fig 6, tregohet pesha e tregtisë së çdo vendi të BP6 me pesë partnerët e tij të mbetur brenda rajonit.

Tregtia ndërrajonale është më e lartë për Kosovën dhe Malin e Zi, ndërsa dukshëm më e ulët për Shqipërinë. Për më tepër, rëndësia e tregtisë brenda BP6 shfaq tendenca në rënie vitet e fundit, veçanërisht për Serbinë, Maqedoninë e Veriut dhe Kosovën, ndërsa tendencat rritëse vetëm për dy vende për Shqipërinë dhe Bosnje-Hercegovinën.

Figura 6: Tregtia ndërrajonale e vendeve të BP6 me 5 (pesë) vendet partnere të rajonit



Burimi: The Observatory of Economic Complexity (OEC), 2022

Potenciali për të rritur tregtinë dhe për të nxjerrë përfitime nga integrimi më i thellë varet kryesisht nga zhvillimi i prodhimit dhe nga karakteristikat strukturore të tij (Brada, J. C, et al, 1983). Për të analizuar karakteristikat rajonale të prodhimit, mund të llogarisim indeksin e specializimit rajonal të (Krugman, P., 1991).

Figura 7, tregon tendencat në indeksin e specializimit rajonal. Indeksi i specializimit rajonal është më i ulët se një që tregon se sektori i prodhimit është nuk është i specializuar në rajonin BP6. Sa i përket Shqipërisë, ka tendenca të despecializimi, veçanërisht me Maqedoninë e Veriut, dhe

specializimi në rritje me Kosovën. Intensiteti më i ulët tregtar brenda BP6 mund t'i atribuohet pjesërisht nivelit të ulët të specializimit të sektorit të prodhimit. Megjithatë, me lëvizjen e lirë të njerëzve, mallrave dhe shërbimeve, pritet riorganizimi i prodhimit brenda rajonit sipas madhësisë së tregut, grupit të vendeve të punës së kualifikuar dhe zhvillimit infrastrukturor. Për të korrur të gjitha përfitimet e tregtisë liberalizimi në rajon, marrëveshjet e tregtisë së lirë duhet të jenë të plota dhe të zbatuara në mënyrë efikase.


Figura 7: Indeksi i specializimit ndërrajonal të prodhimit midis vendeve të BP6

	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020
Shqipëri-Bosnja Hercegovina				0.56	0.56	0.71	0.67	0.67	0.79	
Shqipëri-Kosova				0.83	0.93	0.84	0.95	0.9	0.99	
Shqipëri-Maqedonia e Veriut				0.58	0.4	0.46	0.4	0.6	0.52	
Shqipëri-Serbi				0.61	0.56	0.63	0.79	0.78	0.81	
Bosnja Hercegovina-Maqedonia e Veriut	0.62	0.64	0.58	0.58	0.6	0.63	0.66	0.67	0.77	0.75
Bosnja Hercegovina-Serbi	0.49	0.51	0.5	0.5	0.45	0.51	0.41	0.48	0.55	
Kosova-Bosnja Hercegovina	0.9	0.72	0.77	0.77	0.76	0.73	0.71	0.66	0.64	0.5
Kosova-Maqedonia e Veriut	0.67	0.88	0.97	0.97	0.82	0.79	0.89	0.7	0.82	0.65
Kosova-Serbi	0.77	0.59	0.63	0.63	0.6	0.61	0.69	0.48	0.62	
Maqedonia e Veriut-Serbia	0.67	0.64	0.71	0.65	0.51	0.53	0.53	0.52	0.53	

Burimi: International Labor Organization (ILO), 2022

Pas ndryshimit të regjimit në vendet e Ballkanit Perëndimor, tregjet e rajonit u hapën për të mirëpritur investimet e huaja direkte (IHD) duke mbështetur pozitivisht ekonominë dhe ndryshimet strukturore. Flukset hyrëse të IHD-ve janë tërhequr kryesisht nëpërmjet proceseve të privatizimit të ndërmarrjeve shtetërore dhe koncesioneve të lidhura me burimet natyrore. Në fakt, e njëjta gjë aplikohet sot; kur bëhet fjalë për investimet e huaja rajoni i Ballkanit Perëndimor vazhdon të duket tërheqës për investitorët e interesuar për të shfrytëzuar burimet e shumta natyrore, rezervat dhe afërsinë gjeografike me tregun kryesor të BE-së. Ballkani Perëndimor është vulnerabël në lidhje me krizat financiare

dhe ekonomike të viteve 2009 dhe 2012, duke u shfaqur në flukset e brendshme të IHD-ve. Me vendet e origjinës kryesore të goditura nga kriza, një prirje rënëse ka karakterizuar vëllimin e investimeve të huaja që kanë hyrë në rajon. Figura 8 tregon flukset dhe kontributet rajonale të IHD-ve në milionë dollar të çdo vendi. Në tetë vitet e fundit raporti i IHD-ve është mjaft i qëndrueshëm (me përjashtim të vitit 2016 dhe viteve të pandemisë), megjithatë sa herë një prej vendeve përjeton rritje pozitive në flukset hyrëse të IHD-ve për frymë, të paktën një tjetër vend i rajonit pëson rënie. Kjo ilustron konkurrencën që ekziston midis Vendet e BP6 në tërheqjen e IHD-ve (UNCTAD, 2022).

Figura 8: Flukset hyrëse të IHD-ve në vendet e rajonit të BP6 (në milion USD)

Burimi: UNCTAD, 2022

Për shkak të avantazheve të rëndësishme konkurruese dhe potencialit të rritjes të ekonomive BP6 përfaqësojnë një destinacion tërheqës për investitorët e huaj në kërkim të mundësive. Megjithatë, rajonalizimi dhe integrimi i mëtejshëm ekonomik duhet të jetë në krye të agjendave të diplomacisë ekonomike të BP6 në mënyrë që të intensifikohen marrëdhëniet ekonomike ndërmjet vendeve të rajonit dhe të përshpejtohet procesi i konvergencës ekonomike.

Gjatë dekadave të fundit, turizmi ka përjetuar rritje të vazhdueshme dhe është diversifikuar për t'u bërë një nga sektorët ekonomikë me rritjen më të shpejtë në rajonin e Ballkanit Perëndimor (UNWTO, 2019), duke u rritur nga më pak se 4 milion vizitorë të huaj në 1999 në

më shumë se 13 milion në 2019 para se pandemia Covid-19 të fillonte. Për shkak se rajoni është i "pazbuluar" dhe "i panjohur", sot i gjithë rajoni i Ballkanit po kalon një epokë të artë në rritje të turizmit. Rëndësia në rritje e turizmi në strukturën ekonomike të Ballkanit vendeve është i pamohueshme (Cvetkoska, V., 2017) veçanërisht për ekonominë e Shqipërisë dhe Malit të Zi. Viti 2020 shënon ulje të flukseve të vizitorëve të huaj në të gjithë rajonin për shkak të rregullave dhe kufizimeve të vendosura në kuadër të pandemisë globale. Portat e Bashkimit Evropian u mbyllën tërësisht për vendet jashtë rajonit. Kjo krijoi mundësi për lëvizje të shtuar brenda rajonit kur shumë vende vendosën reduktimin dhe eliminimin e masave anticovid.

Figura 9: Flukset hyrëse të turistëve të huaj në vendet e rajonit BP6 (në mijë persona)

	1999	2010	2015	2019	2020	2027*	Kontributi turizmit (në % të PBB)
Shqipëria	39	2191	3784	6406	2604	6250	21.20%
Bosnja-Hercegovina	89	365	678	1198	197	1018	9.80%
Kosova	N/A	34	79	N/A	N/A	N/A	N/A
Maqedonia e Veriut	181	262	486	758	118	754	32.10%
Mali i Zi	N/A	1088	1560	2510	351	2978	6.20%
Serbia	N/A	683	1132	1847	446	2095	5.90%

Burimi: United Nation World Tourism Organization (UNWTO), 2022, *parashikime

Turizmi merr një rol thelbësor në zhvillimin socio-ekonomik, veçanërisht në vendet në zhvillim. Kjo industri në rajonin e BP6 është një faktor i rëndësishëm në procesin e demokratizimit, duke vepruar si shtytës për integrimin ndërrajonal dhe në institucionet euroatlantike (Benner, M., 2019). Për këtë arsye, turizmi, politikat dhe zbatimi i tyre janë qendrore për vendet e BP6. Megjithatë, ndërvarësia e fortë e turizmit me sektorë të tjerë si mjedisi, arsimit, shëndetësia dhe transporti, e bëjnë edhe më sfiduese zhvillimin e tij. Për shembull, sektori i turizmit mbështetet në mënyrë të rëndësishme në kapitali njerëzor lokal, që do të thotë se punonjësit e mikpritjes duhet të jenë të trajnuar në mënyrë rigoroze për punë të veçanta (sektori i arsimit) dhe se lëvizshmëria duhet të lehtësohet si në aspektin infrastrukturor ashtu edhe në zhvillimin e transportit publik (sektori i transportit). Sektori i turizmit pritet të ketë një ndikim të konsiderueshëm në arenën e politikave dhe të ndërlihet me fusha të tjera të politikave për të

bërë ndryshimet e nevojshme. Rrjedhimisht, një zgjidhje e mundshme është vendosja e politikave të përbashkëta turistike mes vendeve të rajonit. Strategjitë dhe veprimet e përbashkëta për turizmin mund të mbështesin nevojën për bashkëpunim rajonal që dalin nga iniciativat e fundit (OECD, 2018). Metodijeski dhe Temelkov në punimin e tyre në vitin 2014 dalin në përfundimin se hapi i ardhshëm për vendet e BP6 duhet të jetë futja e përbashkët në tregun e turizmit ndërkombëtar si dhe promovim reciprok dhe i përbashkët. Duke marrë parasysh ngjashmëritë e rëndësishme mes mundësive dhe sfidave për zhvillimin e sektorit të turizmit në secilin prej vendeve, krijimi i një grupi politikash funksionale turistike të përbashkët dhe aleancat strategjike mund të përfaqësojnë një mundësi për të gjithë rajonin. Të tillë iniciativa nuk do të zëvendësojnë aspak autoritetet lokale ose rajonale, rëndësia e të cilave është e evidente, por më tepër do t'i integrojë ato brenda një strukture shumë dimensionale.

6. Përfitimet dhe Risqet e Nismës Open Balkan

Pavarësisht numrit të lartë të iniciativave të ndërmarra, ka ende një sërë faktorësh që pengojnë integrimin më të fortë ekonomik në Ballkanin Perëndimor. Barrierat fizike në tregti rrjedhin nga orët e gjata të pritjes për kamionët në pikat kufitare për shkak të procedurave të rënduara burokratike. Barrierat fiskale rrjedhin nga norma të ndryshme fiskale: për të tërhequr IHD-të, qeveritë kanë konkurruar duke ulur taksat dhe duke ofruar stimuj të ndryshëm për investitorët e huaj. Barrierat teknike përbëhen nga standarde të ndryshme sanitare dhe fitosanitare, norma në lidhje me farmaceutikët, kriteret e etiketimit të origjinës ushqimore ose legjislacioni i punës (Uvalic, M., 2020).

Ka tri arsye kryesore pse përpjekjet për integrimin ekonomik rajonal të deritanishme nuk kanë prodhuar rezultate më efikente. Së pari, strukturat ekonomike nuk janë veçanërisht mbështetëse për integrimin rajonal. Rajoni BP6 ka komplementaritet në strukturat rajonale të prodhimit por madhësia e vogël dhe niveli i ulët i zhvillimit ekonomik të ekonomive të rajonit kufizon përfitimet që sjellë integrimi. Së dyti, integrimi i suksesshëm ekonomik rajonal kërkon institucione funksionale. Kjo ka rëndësi për shembull në harmonizimin e legjislacionit për të lehtësuar tregtinë e mallrave dhe shërbimeve përtej kufijve. Së fundi (shumë do të argumentonin, më e rëndësishmja), procesi i integritit ekonomik rajonal në Ballkanin Perëndimor nuk ka pasur kurrë një mbështetje të mjaftueshme politike elitare. Edhe pse sonda-

zhe të tilla si Barometri Ballkanik tregojnë nivele të larta të mbështetjes mes qytetarëve për bashkëpunimin rajonal në një kuptim të gjerë, kjo shpesh nuk është përkthyer në nivelin politik. Vendet kanë vazhduar të konkurrojnë me njëri-tjetrin për të tërhequr IHD-të dhe liderët shpesh kanë dështuar të investojnë kapital politik në iniciativa që do të thellonin vërtetë integrimin ekonomik rajonal. Roli i Serbisë këtu është veçanërisht i rëndësishëm: ajo ka ndërtuar marrëdhënie gjithnjë e më të thella ekonomike jo vetëm me BE-në, por edhe me Rusinë dhe Kinën, duke përforcuar prioritizimin e lidhjeve ekonomike jashtë dhe jo brenda rajonit. Open Balkan është iniciativa e vetme rajonale e kërkuar dhe e krijuar tërësisht nga vetë vendet e rajonit të Ballkanit Perëndimor. Më shumë se çdo gjë tjetër kjo dëshmon për vullnetin politik të vendeve të rajonit për t'iu përkushtuar bashkëpunimit rajonal si asnjëherë më parë. Veçanërisht për këtë arsye iniciativa Open Balkan pritet të jetë një katalizator i rëndësishëm për integrimin rajonal duke sjellë përfitime të rëndësishme dhe të shtuara krahasuar me iniciativat paraardhëse (European Western Balkan, 2022).

Nisma e Open Balkan ofron një integrim më të thelluar për vendet pjesëmarrëse, duke demonstruar një angazhim të qartë për krijimin e një tregu të përbashkët funksional. Krijimi i një tregu të integruar të ngjashëm me BE-në, i cili është qëllimi përfundimtar i iniciativës, përfundimisht do të bënte të tepërt çdo kontroll kufitar. Prandaj, hapat e parashikuar nga nisma e Open Balkan janë thjesht mjete për të arritur zbatimin

e plotë të katër lirive thelbësore dhe një nivel të avancuar të bashkëpunimit ekonomik dhe shoqëror për të cilin është rënë dakord tashmë nga BP6. I mbështetur nga arsyetimi ekonomik dhe politik, ai dëshmon për rritjen e besimit midis liderit politik dhe është një rrugëdalje nga barra historike. Afërsia gjeografike kushtëzon tregtinë dhe lidhjet shoqërore të cilat nuk do të zhduken me anëtarësimin në BE. Duke qenë se synimet e kësaj iniciative janë në përputhje të plotë me vlerat e BE-së, Open Balkan ka potencialin për të forcuar perspektivën evropiane të rajonit (Ristic, D., 2021).

Në samitin e Shkupit, liderët e vendeve anëtare të Open Balkan shpallën një agjendë ambicioze që do të sillte shfuqizimin e plotë të kontrolleve kufitare midis vendeve të tyre deri më 1 janar 2023, si për qytetarët ashtu edhe për tregtinë, duke kursyer potencialisht deri në 2.7 miliardë euro çdo vit, sipas vlerësimeve të Bankës Botërore. Për të lehtësuar zonën e lëvizjes së lirë, do të vendosen korsi të veçanta për qytetarët dhe mallrat që vijnë nga vendet pjesëmarrëse të Ballkanit të Hapur në pikat kufitare ku nuk do të bëhet asnjë kontroll. Në këtë takim u njoftua nga liderët përkatës se po bashkëpunojnë ngushtë me bizneset për ulje të mundshme në hotele dhe restorante të ndryshme për qytetarët e tyre duke nxitur më tej turizmin në rajon. Heqja e plotë e kontrolleve kufitare dhe krijimi i një zone të lëvizjes së lirë si Shengen, mund të sjellë deri në 6-9% kosto operative më të ulëta për bizneset, sipas të dhënave të paraqitura në Samitin e Shkupit, duke rritur gjithashtu konkurrencën e tyre dhe në të njëjtën kohë duke i bërë këto vende destinacione atraktive të pushimeve për qytetarët e tyre.

Lëvizja e lirë e kapitalit njerëzor dhe forcës së punës

Zgjerimi i tregut të punës midis vendeve pjesëmarrëse mund të jetë një avantazh si për punëdhënësit ashtu edhe për punëmarrësit e këtyre vendeve. Punonjësit e rinj në treg, por edhe ata ekzistues mund të ofrojnë aftësitë e tyre në vendet fqinje. Nga ana tjetër punëmarrësit në kërkim të forcës punëtore mund të ofrojnë mundësi punësimi në vendet e Open Balkan. Për më tepër rritja e tregut të punës ofron mundësi të shkëmbimit të eksperiencës në tregun e punës. Nxitja e punësimit pritet të ndodhë prej shtimit të kërkesës dhe ofertës së

ose në forma të organizuara.

Individualisht, punëkërkuessit mund të shikojnë mundësitë e punësimit në bizneset e rajonit duke aplikuar sipas aftësive të tyre. Gjithashtu punëdhënësit në kërkim të punonjësve mund të shikojnë mundësinë e ofrimit të punës në vendet e rajonit. Në mënyrë alternative në forma të organizuara do të nxitet edhe bashkëveprimi i punëdhënësve për shkëmbimin e forcave të punës midis tyre duke përdorur eksperiencat respektive dhe duke u rregulluar me marrëveshje midis bizneseve në rajon. Impakti vlerësohet se do të jetë akoma më i rëndësishëm në industritë me flukse pune sezonale. Gjithashtu bashkëveprimi midis shoqatave si konfidustria dhe dhomave tregtare të bizneseve do të ishte i rëndësishëm për të bashkërenduar përdorimin efiçent të forcave të punës. Ndërsa bizneset dhe organizatat jofitimprurëse mund të konsiderojnë mundësinë për shtrirjen e aktiviteteve të tyre në nivel rajonal. Një formë tjetër e cila do të nxishte rritjen e punësimit do të ishte edhe bashkëveprimi i qeverive respektive nëpërmjet zhvillimit të mëtejshëm të projekteve të punësimit të përbashkëta. Në kushte të sfidës së përbashkët të largimit të të rinjve nga vendi, nisma e qeverisë shqiptare nëpërmjet Ministrit të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes dhe Ministrit të Shtetit për Rininë dhe Fëmijë për praktikën e punës në institucionet publike dhe private për krijimin e sekretariatit të databazave të të rinjve punëkërkuess dhe projekteve të mbështetjeve së start-up-ve mund të shtrihet më tej në koordinim me qeveritë e vendeve të Maqedonisë së Veriut dhe Serbisë.

Lëvizja e lirë e mallrave dhe shërbimeve

Lëvizja e mallrave dhe shërbimeve pritet të nxitet përmes lehtësirave të krijuara të procedurave doganore, rregullave dhe harmonizimit të kërkesave ligjore si edhe lehtësirave që do të krijohen nga lëvizja e lirë e njerëzve. Marrëveshja ndërmjet administratave doganore të Maqedonisë së Veriut dhe Shqipërisë për një sportel me një ndalesë në pikën kufitare Qafthanë dhe me Serbinë në pikën kufitare Tabanovca me qëllim që të bëhet Non-Stop-Shop (kalime kufitare pa ndalesa) është një hap i rëndësishëm në lehtësimin e procedurave doganore. Element tjetër i rëndësishëm është rishikimi i tarifave doganore të cilat do të duhet të përshtaten në kuadër të kësaj nisme me qëllim shmangien e

dublikimit të këtyre tarifave për mallrat e importuara jashtë rajonit në një prej vendeve të Open Balkan. Kjo do të nxisë lëvizjen e mallrave të cilat vijnë në rajon me rrugë detare, tokësore apo ajrore dhe marrdhëniet tregtare midis vendeve të BE dhe jashtë BE si edhe vendeve të Open Balkan. Tarifat e ndërmjetme nga lëvizjen e mallrave brenda territorit të Open Balkan duhet të rishikohen dhe dakortësohen midis palëve me qëllim lehtësimin e këtyre të tarifave ndaj bizneseve të vendeve respektive. Harmonizimi i kërkesave ligjore dhe rregullatore për lëvizjen e mallrave, kushteve të transportit, dokumentat shoqëruese dhe kontrollet e koordinuara do të stimulonte tregtinë midis vendeve. Lëvizja e lirë e mallrave nuk mund të shikohet e ndarë nga lëvizja e lirë e njerëzve që do të angazhohen në zinxhirin e furnizimit të mallrave midis vendeve. Duke konsideruar nevojat e vendeve respektive të vendeve të Open Balkan lëvizja e mallrave do të nxisë konsumin e produkteve agrikulurore dhe industriale midis vendeve. Duke patur parasysh që Shqipëria ka një përqendrim më të lartë të PBB -së nga bujqësia me mbi 21% krahasimisht me Maqedoninë e Veriut dhe Serbinë të cilat kanë përqendrim respektivisht 8% dhe 6%, produktet bujqësore shqiptare mund të gjejnë treg në dy vendet e tjera të Open Balkan. Sigurisht lind nevoja për analizimin e mëtejshëm të produkteve bujqësore të prodhuara në vend dhe kërkesave nga vendet përkatëse. Ngjashmërisht, dy vendet e Open Balkan Maqedonia e Veriut dhe Serbia kanë përqendrim më të lartë të PBB-së të produkteve industriale respektivisht me 25% dhe 26 % krahasuar me Shqipërinë në nivelin prej 15%. Rrjedhimisht produktet industriale të këtyre vendeve mund të gjejnë treg në Shqipëri. Sigurisht lind nevoja për analizimin e mëtejshëm të produkteve industriale të prodhuara dhe kërkesave për to në vendet respektive. Industria në Shqipëri është e fokusuar kryesisht në industrinë nxjerrëse të mineraleve dhe naftës bruto, kurse në vendet e tjera të Open Balkan fokusi është më tepër në industrinë përpunuese. Kjo përbërje e strukturës së ekonomisë bën të mundur që ekonomitë e Open Balkan të jenë plotësuese të njëra-tjetrës dhe të kenë mundësi për specializim të mëtejshëm duke rezultuar në indeks të specializimit rajonal më të lartë për të përfituar sa më shumë nga integrimi rajonal dhe tregtia midis vendeve të BP6.

Të tre vendet e iniciativës Open Balkan kanë një përqendrim të lartë të PBB-së (rreth 60%) dhe

ofrojnë fuqi punëtore të specializuar në sektorin e shërbimeve. Sektori i shërbimeve mund të ofrohet përtej kufijve respektive të secilit vend duke përdorur ekspertizën përkatëse si simbiozë të mbulimit të nevojave të tregut të përbashkët të Open Balkan. Nxitja e bashkëpunimeve në sektorin e shërbimeve ndërmjet konsortiumeve midis shteteve për ofrimin e shërbimeve ndaj investitorëve të huaj dhe atyre rajonale që operojnë në territorin e Open Balkan do të sjellë përfitime të shtuara për ekonomitë përkatëse. Për më tepër foka punëtore e fokusuar tek shërbimet mund të zhvendosët sipas sezonalitet të kërkesës për shërbime midis vendeve nëpërmjet marrëveshjeve me kushte lehtësuese të parashikuara nëpërmjet harmonizimit të kuadrit rregullator dhe ligjor (Zyrat statistikore të vendeve të BP6, 2022).

Aspekti Fiskal i Nismës Open Balkan

Shtetet e Open Balkan kanë norma tatimi mbi fitimin respektivisht Shqipëria 15%, Maqedonia e Veriut 10% dhe Serbia 10%. Këto norma janë relativisht të ulta krahasuar me vendet e tjera dhe vendet e BE-së duke tërhequr investitorët e huaj.

Shoqëritë të regjistruara për tatimin mbi fitimin për nivelin e të ardhurave deri në 14 milionë lekë në vit kanë një normë të aplikueshme prej 0%. Shoqëritë të cilat janë subjekt i tatimit të thjeshëtuar kanë një normë tatimore prej 0% për të ardhurat të cilat nuk kalon 8 milionë lekë në vit. Ndërkohë shoqëritë që operojnë në zhvillimin e software dhe shoqëritë me aktivitet kryesor në agrikulturë mund të përfitojnë nga norma e reduktuar e tatimit prej 5% deri në 10 vite (PWC, 2022). Edhe pse Shqipëria ka normën e tatimit mbi fitimin më të lartë nga të treja vendet e Open Balkan, lehtësimet fiskale për biznesin e vogël dhe shoqëritë e shërbimit të Software-ve dhe agrikulturës stimulojnë shtimin e bizneseve të vogla nga investitorët. Lehtësira fiskale të biznesit të vogël mund të nxisin investitorët e Maqedonisë së Veriut dhe Serbisë të inkorporojnë bizneset e tyre në Shqipëri parë kjo edhe në kuadër të lëvizjes së lirë të njerëzve dhe mallrave në territorin Open Balkan.

Sipas drejtorisë së përgjithshme të tatimeve Shqipëria aktualisht ka marrëveshje për shmangjen e tatimit të dyfishtë me Serbinë por ende nuk ka lidhur një marrëveshje të shmangjes së tatimit të dyfishtë me Maqedoninë e Veriut (Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, 2022).

Normat e tatimit mbi dividendin për residentët e vendeve respektive janë 8% për Shqipërinë, 10% për Maqedoninë dhe 10% për Serbinë (Deloitte Highlights, 2019). Asnjë prej vendeve nuk mban tatim mbi dividendin nëse ai i shpërndahet shoqërive subjekt i tatimit fitimit në regjimet fiskale respektive të vendeve. Të treja vendet kanë norma relativisht të ulta të tatimit

mbi dividendët për residentët. Në kuadër të iniciativës së Open Balkan mund të krijohen marrëveshje edhe për rishikimin e normës së tatimit mbi dividendët për të gjithë taksapaguesit e vendeve të Open Balkan me mundësinë e përshtatjes së trajtimit të tyre si resident të territorit të përbashkët.

Figura 10: Aspekti fiskal i iniciativës Open Balkan

	Aspekti fiskal		
	Shqipëria	Maqedonia e Veriut	Serbia
Norma e Tatim - Fitimit	15%	10%	10%
Norma e Tatimit të Dividentit	8%	10%	10%
Tatimi mbi Vlerën e Shtuar TVSH	20%	18%	20%

Burimi: PWC, 2022

Në përgjithësi, rregulloret e TVSH-së janë në përputhje me dispozitat e Direktivës së gjashtë të TVSH-së të Bashkimit Evropian (BE). Aktualisht Shqipëria aplikon një normë të TVSH në masën 20% mbi furnizimet sipas Ligjit nr. 92/2014 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë". Norma e reduktuar e TVSH-së prej 10% zbatohet për disa produkte si furnizimi i inputeve bujqësore, përfshirë plehrat kimike, pesticidet, farat dhe fidanët. Gjithashtu ligji i TVSH-së ofron një listë të furnizimeve që konsiderohen si të përjashtuara nga TVSH-ja.

Në Maqedoninë e Veriut norma standarde e TVSH-së është 18%. Kjo normë vlen për qarkullimin e përgjithshëm dhe importet e mallrave dhe shërbimeve. Përveç TVSH-së standarde prej 18%, norma preferenciale prej 5% dhe 10% aplikohen për qarkullimin e mallrave dhe shërbimeve të caktuara.

Ndërsa në Serbi norma standarde e TVSH-së është 20% për shumicën e furnizimeve të tatueshme. Një normë e reduktuar e TVSH-së prej 10% zbatohet për ushqimet bazë, gazetat e përditshme, ilaçet, botimet, shërbimet e transportit publik, shërbimet komunale etj. Përveç këtyre normave tatimore, ekziston një normë tatimore 0% me të drejtë zbritjeje të TVSH-së hyrëse që zbatohet për eksportin e mallrave, transportit dhe shërbimeve të tjera që lidhen drejtpërdrejt me eksportet, transportin ajror ndërkombëtar (PWC, 2022).

Në përgjithësi, rregulloret e TVSH-së në të treja shtetet e Open Balkan janë në përputhje me dispozitat e Direktivës së gjashtë të TVSH-së të BE. Siç shikohet më sipër të treja vendet aplikojnë një normë të përafërt mbi TVSH dhe zbatojnë gjithashtu lehtësira të ndryshme mbi produkte dhe furnizime të ndryshme. Është për t'u theksuar që ligjet dhe rregulloret mbi TVSH janë të harmonizuara me direktivën Evropiane. Megjithatë një analizë e thelluar do të ndihmonte për harmonizimin e plotë të ligjeve dhe rregulloreve jo vetëm me vendet e BE-së por edhe me ato të Open Balkan. Kjo analizë mund të marrë për bazë modelin Evropian për ngritjen e një sistemi të përbashkët të kreditimit të TVSH. Iniciativa e Open Balkan mund të kërkojë lidhjen e marrëveshjeve të ndryshme për kreditimin e TVSH-së dhe aplikimin të "reverse charge" për furnizimet brenda hapësirës së përbashkët Open Balkan edhe dakortësimin mbi lehtësimet dhe përjashtimet e një game të përbashkët të furnizimeve në territorin e Open Balkan. Kjo do të lehtësonte procedurat mbi aplikimin e TVSH-së dhe raportimin nga ana e autoriteteve fiskale, si edhe do të stimulonte konsumin dhe investimet brenda territorit të përbashkët. Një analizë e thelluar do të nevojitet për të vlerësuar impaktin e iniciativës mbi aspektet fiskale me fokus të zgjeruar mbi të gjitha ligjet dhe rregulloret përkatëse fiskale, tatimit mbi te ardhurat, TVSH, taksave lokale, taksave të pronave, tarifave doganore etj.

Lëvizja e kapitalit dhe investimeve lokale dhe të huaja

Lëvizja e lirë e njerëzve, mallrave dhe shërbimeve nxit si rrjedhojë edhe lëvizjen e kapitalit. Investitorët lokal stimulohen të investojnë kapitalin e tyre në vendet e Open Balkan të nxitur nga lehtësirat e transferimit të fuqisë punëtore, përshtatjes së kuadrit rregullator dhe ligjor dhe lëvizjes së lirë të mallrave dhe shërbimeve. Për më tepër investitorët mund të jenë të interesuar të integrojnë investimet e tyre përtej aktiviteteve të tyre të zakonshme. Një prodhues në një treg të vogël mund të zgjerojë gamën e aktiviteteve. Një investitor në industrinë nxjerrëse mund të konsiderojë zgjerimin edhe në industrinë përpunuese duke përdorur ekspertizën dhe infrastrukturën midis tyre.

Ndërkohë një ofrues shërbimesh mund të rrisë gamën e shërbimeve si edhe mund të zgjerojë aktivitetin e tij në të gjithë territorin e Open Balkan.

Investitorët e huaj mund të jenë të interesuar

për të rritur investimet e tyre kapitale në një treg me të madh duke konsideruar lehtësirat për gjetjen e burimeve të shtuara në njerëz si edhe një treg me të madh të mallrave dhe shërbimeve. Nga ana tjetër marrëdhëniet e mira midis tre vendeve të Open Balkan dhe vendeve të tjera do të kenë ndikimin e tyre në rritjen e investimeve në gjithë territorin e Open Balkan. Ndërkohë një ofrues shërbimesh mund të rrisë gamën e shërbimeve si edhe mund të zgjerojë aktivitetin e tij në të gjithë territorin e Open Balkan.

Investitorët e huaj mund të jenë të interesuar për të rritur investimet e tyre kapitale në një treg me të madh duke konsideruar lehtësirat për gjetjen e burimeve të shtuara në njerëz si edhe një treg me të madh të mallrave dhe shërbimeve. Nga ana tjetër marrëdhëniet e mira midis tre vendeve të Open Balkan dhe vendeve të tjera do të kenë ndikimin e tyre në rritjen e investimeve në gjithë territorin e Open Balkan.

6.1. Analiza SWOT

Një analizë SWOT është një përmbledhje e pikave të forta, dobësive, mundësive dhe kërcënimeve të projektit. Objektivi kryesor i kësaj analize është të ndihmojë palët të zhvillojnë një vetëdije të plotë për të

gjithë faktorët e përfshirë në marrjen e vendimit të integrit të shtuar rajonal. Një analizë SWOT e thjeshtuar për iniciativën e Open Balkan është paraqitur më poshtë:

Figura 11: Tabela e Analizës SWOT

Pikat e Forta	Mundësitë
<ul style="list-style-type: none"> - Marrëdhënie e mirë midis qeverive të vendeve të Open Balkan; - Dakortësi e plotë midis qeverive të vendeve të Open Balkan; - Afërsi gjeografike e vendeve të Open Balkan; - Investime në fazë përfundimi në infrastrukturë – Rruga e Arbërit; - Minoritetet Serbe dhe Shqiptare në vendet respektive dhe aftësia për të komunikuar në gjuhët serbe, maqedonase dhe shqipe; - Përdorues të shumtë të gjuhës angleze; - Të trija vendet kanë moshë mesatare relativisht të re; - Standard jetese relativisht i përafërt - Të tri vendet kanë harmonizuar kuadrin ligjor në mënyrë të konsiderueshme me direktivat evropiane; - Aspirata të përbashkëta për integrimin në BE; - Marrëdhënie të mira me vendet e BE-së dhe jashtë saj. 	<ul style="list-style-type: none"> - Ekonomi të ngjashme të fokusura në shërbime; - Potencial për zhvillimin agrikoror; - Mundësi për rritje të punësimit përmes lëvizjes së lirë; - Incentiva për rritjen e tregtisë së mallrave dhe shërbimeve; - Rritje në tregjet e eksportit; - Cilësia e produkteve të huaja po përmirësohet; - Zgjerimi i pikave të shitjes dhe i mbulimit të territorit; - Kostot e punës janë relativisht të ulëta; - Potencial të mirë për zhvillimin e turizmit midis vendeve dhe diversitetit të tij; - Norma taksimi relativisht të ulëta; - Lehtësira tatimore për furnizime të ndryshme; - Mundësi zgjerimi të aktiviteteve të bizneseve përmes territorit të Open Balkan; - Mundësi të shkëmbimit të eksperiencës; - Mundësi të zgjerimit të stimulimit të të gjitha industrive të ekonomive respektive.

Pikat e dobëta	Kërcenimet
<ul style="list-style-type: none"> - Vende me ekonomi informale relativisht të lartë; - Vende të kategorizuara si ekonomi në zhvillim; - Mungesa e eksperiencës; - Mungesa e infrastrukturës të sistemeve teknologjike; - Mungesa të kuadrit rregullator dhe procedurave të harmonizuara; - Këndvështrimi i vendeve fqinje dhe qasja e tyre ndaj nismës; - Ambient kontrolli i paformalizuar; - Nevoja për trajnime administrative respektive; - Sisteme tatimore të ndryshme; - Diferenca kulturore dhe zakonore; - Monedha të ndryshme operimi; - Histori e konflikteve ndëretnike; - Debatimi mbi Kosovën dhe njohjen e saj; - Histori e shkurtër e turizmit ndërkombëtar. 	<ul style="list-style-type: none"> - Rezistenca nga grupet e interesit, vendet fqinje, bizneset, punonjësit; - Rreziku i mospranimit në BE të vendeve të Open Balkan; - Qasja e BE-së dhe SHBA-së ndaj iniciativës Open Balkan; - Rritja e influencës së Rusisë në territorin e Open Balkan; - Tërheqja e investitorëve që janë kundër operimit në territorin e Open Balkan; - Vështirësia për implementimin dhe monitorimin e procesit; - Moszbatimi i afateve; - Mospërballimi i kostove të implementimit; - Rreziku i mosimplementimit të sistemeve kompjuterike të duhura dhe të plota për zbatimin e OB - Rreziku i krijimit të mosmarrëveshjeve midis palëve, punonjësve, qeverive dhe bizneseve midis shteteve të Open Balkan; - Mosdakortësia midis palëve për harmonizimin e procedurave dhe kuadrit rregullator; - Rreziku i kursit të këmbimit; - Rreziku i moszbatimit të marrëveshjeve për procedurat e përbashkëta; - Rreziku i mungesës së monitorimit; - Konkurrueshmëria e produkteve dhe shërbimeve të vendeve të Open Balkan në tregun ndërkombëtar.

Burimi: Përpunimi i autorëve

6.2. Analiza PESTEL

Një analizë PESTEL është një kornizë strategjike që përdoret zakonisht për të vlerësuar mjedisin në të cilin implementohet një projekt. Analiza PESTEL është një akronim për aspektet Politike, Ekonomike, Sociale, Teknologjike, Mjedisore dhe Ligjore. Një analizë e thjeshtuar dhe jo-shërbuese për iniciativën e Open Balkan është praqitur më poshtë:

Aspekti Politik

Ballkani në përgjithësi dhe Ballkani Perëndimor në veçanti, ka qenë arenë e ndeshjeve dhe konflikteve të herëpashershme. Ky konflikt “kontribuoi”, veç të tjerash, që ngarkesave negative të krijuara në vitet e shekujt e mëparshëm midis popujve të rajonit, t’iu shtohen mllëfi, urrejtja dhe mospranimi i njëri-tjetrit. Mosgjetja e zgjidhjeve të qëndrueshme, kryesisht për konfliktin në Bosnje-Hercegovinë dhe atij në Kosovë

nga njëra anë, si dhe drejtësia e vonuar për vënien përpara përgjegjësive penale ndërkombëtare, të personave përgjegjës për ato çfarë ndodhi në ish-Jugosllavi, ka ndikuar negativisht në drejtim të paqes e stabilitetit të rajonit. Ajo që e bën edhe më të vështirë paqen e stabilitetin në Ballkanin Perëndimor është dhe fakti se fryma nacionaliste, e cila qëndronte në themel të konfliktit në ish-Jugosllavi e që përbënte bazën ideologjike të këtij konflikti, vazhdon dhe sot të prodhojë efekte negative, duke u bërë herë pas here pengesë serioze për çdo iniciativë që i kontribuon stabilitetit.

Megjithatë, duket se projekti i integritimit në BE është ai magnet, i cili ka zbehur apo dobësuar së tepërmi projektet nacionaliste apo ato të agjendave të vjetra. Të paktën në dekadën e fundit, qytetarët e Ballkanit Perëndimor kanë filluar të identifikohen më projektin evropian. Përgjithësisht besohet se projekti i integritimit të Ballkanit Perëndimor në BE, madje popujt e rajonit e konsiderojnë si të vetmin proces, i cili garanton transformimin demokratik dhe zhvillimin social dhe ekonomik të rajonit. Ky objektivi i përbashkët ka sjellë një solidaritet, i cili nuk mund të konceptohej dy dekada më parë. Produkti i këtij solidariteti janë edhe një numër jo i pakët i nismave rajonale të cilat synojnë rritjen e shkëmbimeve njerëzore përmes konsolidimit të një zone ekonomike rajonale; përforcimin e rrjetit infrastrukturor rajonal, transportit dhe energjisë, forcimin e dimensionit të sigurisë përmes demokratizimit të shoqërive, bashkërendimin më të mirë të luftës së përbashkët kundër krimit të organizuar, trafiqeve të paligjshme, si dhe përmirësimin e standardeve të menaxhimit të kufijve.

Aspekti Ekonomik

Vendet e Open Balkan kategorizohen si vende në zhvillim, të cilat kanë norma të rritjes ekonomike relativisht më të larta sesa vendet e zhvilluara. Struktura ekonomike e vendeve është e ngjashme me përqendrim të lartë në shërbime në mbi 60%, ku te tri vendet ofrojnë fuqi punëtore të fokusuar në shërbime. Shërbimet mund të ofrohen përtej kufijve respektivë të secilit vend duke përdorur ekspertizën përkatëse si simbiozë të mbulimit të nevojave të tregut të përbashkët të Open Balkan. Open Balkan do të nxisë bashkëpunimet në shërbime të konsorci-umeve ndërmjet shteteve për dhënjen e shërbimeve ndaj investitorëve të huaj dhe atyre rajonale që operojnë në territorin e Open Balkan. Duke konsideruar nevojat e vendeve respektive të Open Balkan, lëvizja e mallrave do të nxisë konsumin e produkteve agrokulturore dhe industriale midis vendeve. Duke pasur parasysh që Shqipëria ka një përqendrim më të lartë të PBB-së nga bujqësia me mbi 21% krahasimisht me

Maqedoninë Veriut dhe Serbinë, të cilat kanë përqendrim respektivisht me afërsisht 8% dhe 6%, produktet bujqësore shqiptare mund të gjenin treg në dy vendet e tjera të Open Balkan. Sigurisht lind nevoja për analizimin e metejshëm të produkteve bujqësore të prodhuara në vend dhe kërkesave për to në vendet e Open Balkan dhe anasjelltas.

Ngjashmërisht, dy vendet e tjera të Open Balkan, Maqedonia e Veriut dhe Serbia, kanë përqendrim më të lartë të PBB-së të produkteve industriale, respektivisht me 25% dhe 26% krahasuar me Shqipërinë në nivelin prej 15%. Produktet industriale të këtyre vendeve mund të gjejnë treg në Shqipëri. Sigurisht lind nevoja për analizimin e mëtejshëm të produkteve bujqësore të prodhuara në vend dhe kërkesave për to në vendet e Open Balkan dhe anasjelltas. Për shembull, industria në Shqipëri është e fokusuar kryesisht në industrinë nxjerrëse të mineraleve dhe naftës bruto, ndërsa në vendet e tjera të Open Balkan është më përqendruar në industrinë përpunuese.

Të dhënat nga Raporti i Konkurrencës Globale tregojnë se rajoni ka përparuar dhe zvogëluar hendekun me BE-në në shumë nga shtytësit e produktivitetit dhe me një normë të parashikuar të rritjes së PBB-së prej 3.8% në vitin 2020. Ballkani Perëndimor mbetet një nga zonat e Evropës me perspektivat më të mira të rritjes për të ardhmen. Megjithatë, nivelet mesatare të të ardhurave janë ende vetëm sa një e katërta e atyre të Gjermanisë dhe, me këtë ritëm, do të duhen më shumë se gjashtë dekada për të kapur BE-në.

Ashtu si ekonomitë e Ballkanit Perëndimor shohin për një rimëkëmbje rritjeje përtej pandemisë, një sërë sfidash të reja ndeshin rajonin. Prodhimi për Ballkanin Perëndimor si i tërë, ka kapërcyer tashmë nivelet e para-pandemisë, por reagimi ndaj COVID-19 ka rezultuar në borxhe më të larta publike dhe ka lënë vraga të qëndrueshme. Rritja potenciale mbetet e shtrënguar nga nevoja për reforma strukturore për të rritur rendimentin, për të rritur konkurrencën, për të investuar në kapitalin njerëzor dhe për të forcuar qeverisjen (Banka Botërore, 2022).

Lufta në Ukrainë po dërgon valë tronditëse anembanë rajonit, veçanërisht nëpërmjet çmimeve më të larta të energjisë dhe ushqimeve, por gjithashtu nëpërmjet ndërprerjes së tregtisë dhe vërshimeve të investimeve, duke vënë në rrezik rimëkëmbjen e rajonit.

Ekonomitë e Ballkanit Perëndimor panë një rritje të fortë në 2021 me një kthim të madh prapa në veprimtarinë ekonomike. Në vitin 2021, rritja e PBB-së në Ballkanin Perëndimor arriti 7.4% pas një tkurrjeje prej 3.2% në vitin 2020. Produkti Kombëtar Bruto pritet tashmë të kapërcejë nivelet e para-pandemisë deri më 2022 (Banka Botërore, 2022).

Aspekti Social

Në krahasim me nivelet evropiane, varfëria dhe rreziku i rënies në varfëri mbeten të larta në vendet e Ballkanit Perëndimor. Studime më të detajuara tregojnë se në vendet e Ballkanit Perëndimor, varfëria shprehet kryesisht si fenomen rural dhe personat e papunë pa arsimin e duhur, familjet me fëmijë (pra familjet me shumë persona) janë ata që janë më vulnerabël. Megjithatë, përqindja e popullsisë urbane në strukturën e të varfërve mbetet gjithashtu e rëndësishme, në veçanti në vendet që monitorojnë riskun e varfërisë së matur mbi bazën e të ardhurave, edhe personat e punësuar gjenden gjithmonë e më shumë përballë këtij risku. Pabarazitë rajonale janë po ashtu të theksuara në të gjitha vendet. Për ilustrim, popullsia e Serbisë lindore dhe jugore është dy herë më e varfër nga mesatarja (përqindja e varfërisë e bazuar tek konsumi ishte 18.0%), dhe qyteti i Kukësit në Shqipëri është 1.5 herë më i varfër (niveli i varfërisë 22.5%). Nivelet e punësimit dhe aktivitetit janë të ulëta, ndërsa ato të papunësisë janë të larta në të gjitha vendet dhe për më tepër, edhe më e përkeqësuar është situata e krahasuar me vendet e BE-së. Njëkohësisht, niveli i papunësisë tek të rinjtë është dy herë më i lartë sesa totali i papunësisë.

Varfëria e përhapur, përqindjet e larta të punësimit në sektorin informal, dhe sidomos niveli i lartë i papunësisë vendosin kërkesa të larta në shtetet e brishta sociale të vendeve të Ballkanit Perëndimor. Rrjetet e sigurimeve shoqërore nuk arrijnë të sigurojnë mbrojtje për një përqindje të madhe të kuantilit më të varfër; rrjedhimisht, të metat kryesore të këtyre skemave kanë të bëjnë me nivelin e ulët të mbulimit (marzh i lartë i gabimeve në përjashtim) dhe pamjaftueshmërinë e përfitimeve (Banka Botërore, 2021).

Aspekti Teknologjik

BE ka vendosur objektiva të qarta për kërkimin dhe inovacionin si pjesë e Strategjisë së Lisbonës për t'u bërë ekonomia më konkurruese në botë. Disa nga objektivat e Forumit Ekonomik Botëror për Ballkanin Perëndimor janë si më poshtë:

1. Të përshpejtojë modelet ekzistuese të suksesit të pilotuara nga fondet kombëtare të inovacionit dhe të krijojë një fond rajonal të koordinuar. Me mbështetjen e Bankës Botërore, janë krijuar fonde inovacioni në Maqedoninë e Veriut dhe Serbi. Ato kanë pilotuar dhe zbatuar programe të suksesshme, por janë ende shumë të fragmentuar për të pasur shkallën e nevojshme që mund të grumbullojë në investime shtesë, veçanërisht nga jashtë rajonit.

2. Bashkëkrijojnë forma novatore stimujsh për të tërhequr programe të suksesshme inkubatori dhe përshpejtuesish nga vendet fqinjë dhe pjesa tjetër e

Evropës. Ballkani Perëndimor ka përjetuar një rritje të qendrueshme në numrin e programeve mbështetëse për startup-et, por ka një nevojë për të sjellë cilësi shtesë në sistem. Një zgjidhje e mundshme do të ishte tërheqja e disa prej lojtarëve të suksesshëm nga jashtë.

3. Të transformojnë Samitin Digjital të Ballkanit Perëndimor në veprimtarinë kryesore mbi inovacionin në rajon me një rol vërtet lidhës për ekosistemin. Takimi i Nivelit të Lartë Digjital i Ballkanit Perëndimor ka qenë një përvojë e suksesshme bashkëpunimi midis gjashtë ekonomive. Ai mund të përqendrohet më shumë në këtë bashkëpunim, apo të zgjerohet në sektorë të tjerë të specializimit të përbashkët në rajon, të tillë si prodhimi i qendrueshëm ushqimor dhe agroteknologjitë.

4. Të krijojë koalicione të bizneseve, qeverive dhe sektorit financiar për të bashkëprojektuar modelet e qeverisjes inovative për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (SME-të), për të nxitur praktikat moderne të biznesit, për të nxitur bashkëpunimin dhe rrjetet mbështetëse midis palëve të ndryshme të interesuara.

5. Të lehtësojë bashkëpunimin dhe shkëmbimin e informacionit me institucionet kryesore kërkimore në botë në sektorët e synuar të kërkimit. Me mbështetjen e Qendrës së Përbashkët Kërkimore të Bashkimit Evropian, shumica e ekonomive të Ballkanit Perëndimor kanë identifikuar fushat me përparësi për investime në kërkim dhe inovacion. Përveç investimit, ata do të përfitojnë nga bashkëpunimi në rritje me universitetet ndërkombëtare dhe qendrat kërkimore në këto fusha.

6. Të themelohet një fond shkencor dhe kërkimor i Ballkanit Perëndimor, i përshtatur për misionet e rajonit. Mandati do të ishte i ndryshëm nga fondi i inovacionit, më shumë i përqëndruar në aplikimet e menjëhershme të biznesit, pasi do të përqëndrohej në sigurimin e kapitalit afatgjatë të pacientëve për misionet kërkimore të synuara që mund të krijojnë rrugë të reja dhe më të qëndrueshme për rritjen.

7. Të ngrejë programe të dedikuara dhe të bashkëprojektojë stërvitje të rregullta largpamëse që përfshijnë qeveritë, sektorin e biznesit, universitetet dhe qendrat kërkimore. Rajoni ndeshet me sfida afatgjata të vështira të tilla si plakja e shpejtë e popullsisë, rrjedhjen e trurit dhe prirjet demografike të pafavorshme. Qeveritë dhe bizneset mund të përfitojnë nga kërkimi në rritje, dialogu dhe shkëmbimi mbi skenarët afatgjatë për rajonin, skanimi i mundësive, kërcënimeve dhe hipotezave të ndërhyrjes (World Economic Forum, 2020).

Aspekti i Mjedisit

Zonat bregdetare në Ballkanin Perëndimor përballen me një grup të mëtejshëm presionesh, të tilla si rrjedh

jet dhe mbetjet e ngurta nga zonat urbane dhe turistike, eutrofikimi i ujërave bregdetare dhe shtrirja përgjatë vijave bregdetare. Mjedisi detar i deteve Adriatik dhe Jon ndikohet nga ndotja e tokës dhe peshkimi i tepërt si dhe presionet nga transporti detar, duke përfshirë transportin e naftës dhe gazit natyror, si dhe nga nxjerrja e gazit natyror në Adriatikon e Veriut (një pjesë e rëndësishme e këtyre presioneve vjen nga vendet jashtë Ballkanit Perëndimor). Vitet e fundit, gjenerimi i mbetjeve komunale është rritur në mënyrë të vazhdueshme në Ballkanin Perëndimor dhe aktualisht vlerësohet të jetë në nivele të ngjashme me ato në BE-12 (të dhënat për mbetjet e ngurta, megjithatë, janë të dobëta). Menaxhimi i mbetjeve komunale është i dobët në shumë pjesë të rajonit dhe shumë objekte të mbetjeve janë të vjetra. Vendet ndajnë shumë burime ujore. Në verë, megjithatë, mungesa e ujit mund të jetë një problem në vendet jugore, në zonat bregdetare dhe në ishuj, veçanërisht në rajonet karstike me rrjedhje.

Ndër sfidat kryesore për vendet e Ballkanit Perëndimor është miratimi dhe zbatimi i ligjeve dhe politikave të reja mjedisore, duke marrë parasysh veçanërisht legjisllacionin e BE-së. Ndërkohë që vendet kanë filluar këtë proces, një sfidë tjetër është ajo e përmirësimit të qeverisjes për të siguruar zbatimin e duhur të masave të reja. Përgatitja dhe përshtatja ndaj ndikimeve të ndryshimeve klimatike do të jetë një tjetër fushë kyçe ku rajoni duhet të përgatitet për të ardhmen. Adresimi i ndikimeve mjedisore të modeleve të konsumit dhe prodhimit do të jetë një tjetër sfidë e madhe.

Duke inkurajuar eficiencën e energjisë në ndërtesa, qeveritë dhe familjet do të jenë në gjendje të reduktojnë ndikimet mjedisore të prodhimit të energjisë. Veprimet për të ngadalësuar rritjen e lëvizshmërisë personale dhe për të frenuar përhapjen urbane mund të zvogëlojnë ndotjen e ajrit. Për vendet e Ballkanit Perëndimor, adresimi i çështjeve mjedisore që lidhen me modelet e konsumit dhe prodhimit mund të ndihmojë në stimulimin e rritjes dhe inovacionit dhe

gjithashtu shmang kostot e ardhshme (përfshirë kostot e zbatimit të rregulloreve të BE-së). Për shembull, investimet për menaxhim më të mirë të mbetjeve mund të frenojnë rritjen e gjenerimit të mbetjeve dhe të ndihmojnë në uljen e kostove të pastrimit të landfilleve të menaxhuara keq. Në industri dhe bujqësi, përpjekje të tilla mund t'i bëjnë ndërmarrjet në rajon më konkurruese (European Environment Agency, 2020).

Të gjithë aktorët në rajon, duke përfshirë qeveritë, biznesin, OJQ-të dhe të tjerët, kanë një rol në formësimin e mjedisit të tij të ardhshëm. Pasiguritë mund të menaxhohen dhe mund të shfaqen zhvillime të dobishme nëse merren parasysh forcat shtytëse në nivelin e duhur (kombëtare, rajonale, vendet fqinje, BE-ja dhe të tjera) nëse të gjithë aktorët e interesuar për zhvillimin e qëndrueshëm të Ballkanit Perëndimor që të shikojnë nga afër forcat dhe tendencat që formojnë të ardhmen dhe të përgatiten për sfidat e dekadave të ardhshme.

Aspekti Ligjor

Të tri vendet e Open Balkan kanë bërë hapa përpara në procesin e integritimit në BE duke harmonizuar një pjesë të konsiderueshme të të gjithë spektrit ligjor dhe rregullator me direktivat e BE-së. Megjithatë, ende vazhdon puna për përshtatje të plotë të rregullave dhe ligjeve të aplikueshme. Rregulloret që rregullojnë bizneset në përgjithësi nuk janë tepër të ngurta, por ato kanë tendencë të ndryshojnë shpesh, duke shtuar spektrin e paparashikueshmërisë në drejtimin e një biznesi në të tri shtetet.

Përsa i perket iniciativës së Open Balkan, lind nevoja e harmonizimit të të gjithë spektrit rregullator dhe ligjor midis shteteve. Një analizë e thelluar do të nevojitet për të vlerësuar impaktin e iniciativës Open Balkan mbi aspektet fiskale me fokus të zgjeruar mbi të gjitha ligjet dhe rregulloret përkatëse fiskale, tatimit mbi të ardhurat, TVSH-në, taksave lokale, akcizave, taksave të pronave dhe tarifave doganore (PWC, 2022).

7. Gjetjet Kryesore

Iniciativa e Open Balkan ndonëse jo e para në llojin e saj, është iniciativa e parë e ndërmarrë nga vullneti i vendeve të rajonit të Ballkanit Perëndimor dhe është vënë në zbatim po nga këto vende pa nevojën e ndërhyrjeve të institucioneve euroatlantike. Kjo tregon se integrimi ndërrajonal në rajon ka filluar të vlerësohet dhe të trajtohet një nga shtyllat kryesore të zhvillimit ekonomik të qëndrueshëm. Nisma e Open Balkan, në kundërshtim me çfarë argumentohet nga vendet të cilat kanë refuzuar të bëhen pjesë e saj, është një nismë e cila nuk e zbeh rëndësinë dhe fokusin drejt anëtarësimit në BE. Vendet e rajonit duhet të kuptojnë se integrimi rajonal nuk është vetëm një mjet për të arritur qëllimin e përbashkët të anëtarësimit në BE por është një proces holistik dhe i vazhdueshëm i cili do të vazhdojë të ketë të njëjtën rëndësi në mos edhe më shumë pas integritimit në BE të gjashtë vendeve të Ballkanit Perëndimor. Qëndrimet e përfaqësuesve të partnerëve kryesorë të BP6 janë shprehur në favor të nismës duke theksuar rëndësinë që ka një nismë e nisur brenda rajonit me vullnetin e mire të palëve.

Objektivat e nismës së Open Balkan janë integrimi ekonomik dhe social i të gjithë vendeve vendeve të BP6. Ky integrim i shtuar do të sigurohet përmes katër lirive kryesore: lëvizja e

lirë e njerëzve, mallrave, shërbimeve, dhe kapitalit; rritja e flukseve ndërrajonale të mallrave dhe shërbimeve; shkëmbimet shkencore dhe kulturore; rritja e konkurrencës së ekonomive relativisht të vogla kombëtare dhe rritja e atraktivitetit të rajonit në tërësi si destinacion investimi. Struktura ekonomike e BP6 është e diversifikuar deri në një fare shkalle duke bërë të mundur të përfitohet nga integrimi i shtuar rajonal dhe flukset rritëse të tregtisë. Në të njëjtën kohë, sektori i shërbimit ka një rëndësi të lartë për të tre ekonomitë e vendeve pjesëmarrëse duke krijuar mundësi të shtuara për shkak të specializimit të forcës punëtore e cila do të gëzojë lëvizshmëri të plotë nën iniciativën Open Balkan. Kjo do të përkthehet në stimuj ekonomik duke rritur investimet e huaja në rajon pa u kufizuar në rritjen e punësimit, stimulimin e tregtisë së mallrave dhe shërbimeve, ndikimin në turizëm etj.

Megjithatë arritja e objektivave nuk mund të realizohet pa kaluar sfida të rëndësishme dhe përgatitje për rreziqet e mundshme që mund të ndikojnë procesin e kësaj nisme strategjike, duke filluar nga kostot e implementimit, krijimin e strukturave implementuese dhe angazhimin e ekspertëve për të ndihmuar procesin e integritimit rajonal.

Referenca

- Agency for Statistics of Bosnia and Herzegovina, 2022. URL: <https://bhas.gov.ba/?lang=en>
- Agjencia e Statistikave të Kosovës, 2022. URL: <https://ask.rks-gov.net/>
- Balkan Barometer, 2022. URL: <https://www.rcc.int/balkanbarometer/>
- Balkan Insight, 2022: NEWS Montenegro Mulls Joining 'Open Balkan' Initiative, Kosovo Remains Opposed. URL: <https://balkaninsight.com/2022/06/08/montenegro-mulls-joining-open-balkan-initiative-kosovo-remains-opposed/>
- Banka Botërore, 2021: Western Balkans Regular Economic Report: Greening the Recovery. URL: <chromeextension://efaidnbmnnnibpajpcgiclfindmkaj/https://openknowledge.worldbank.org/bitstream/handle/10986/36402/Greening-the-Recovery.pdf?sequence=1&isAllowed=y>
- Banka Botërore, 2022: Western Balkans Regular Economic Report: Steering Through Crises. URL: <https://www.worldbank.org/en/region/eca/publication/western-balkans-regular-economic-report>
- Benner, M., 2019: Tourism in the context of smart specialization: The example of Montenegro. Current Issues in Tourism
- BPRG, 2021: Regional Cooperation in The Western Balkans: Regional Economic Area, the "Mini-Schengen" and the Common Regional Market. URL: chrome-extension://efaidnbmnnnibpajpcgiclfindmka-j/https://balkansgroup.org/wp-content/uploads/2021/02/Regional-Cooperation-in-the-Western-Balkans_Regional-Economic-Area-the-mini_schengen-and-the-Common-Regional-Market-WEB-2.pdf
- Brada, J. C., et al 1983: Regional economic integration and the volume of intra-regional trade: A comparison of developed and developing country experience.
- CEFTA, 2021: CEFTA region becomes one market. URL: <https://cefta.int/news/cefta-region-becomes-one-market/>
- Cvetkoska, V., et al, 2017. The efficiency of the tourism industry in the Balkans. Proceedings of the Faculty of Economics in East Sarajevo.
- Deloitte Highlights, 2019. URL: <https://www2.deloitte.com/al/en.html>
- Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, 2022: Marrëveshje Ndërkombëtare. URL: <https://www.tatime.gov.al/c/6/125/marreveshje-nderkombetare>
- European Environment Agency, 2020: Environmental Trends and Perspectives in the Western Balkans. URL: <chrome-extension://efaidnbmnnnibpajpcgiclfindmkaj/https://www.eea.europa.eu/publications/western-balkans/file>
- European Western Balkans, 2022: Open Balkan summit: Agreement on cooperation in the area of recognition of diplomas signed. URL: <https://europeanwesternbalkans.com/2022/06/08/open-balkan-summit-agreement-on-cooperation-in-the-area-of-recognition-of-diplomas-signed/>
- European Western Balkans, 2022: Open Balkan summit: Agreement on cooperation in the area of recognition of diplomas signed. URL: <https://europeanwesternbalkans.com/2022/06/08/open-balkan-summit-agreement-on-cooperation-in-the-area-of-recognition-of-diplomas-signed/>
- Fondacioni Qemal Stafa, 2022: Perspektiva e Ballkanit Perëndimor. URL: <https://fq.al/perspektiva-e-ballkanit-perendimor/>
- Geda, A., et al 2008: Regional Economic Integration in Africa: A Review of Problems and Prospects with a Case Study of COMESA, Journal of African Economies. URL: <https://doi.org/10.1093/jae/ejm021>

- Global Competition Review, 2022. URL: <https://globalcompetitionreview.com/>
- Grieveson, R., 2021: Western Balkan economic integration with the EU: Time for more ambition, Balkans in Europe Policy Advisory Group. URL: <https://biepag.eu/blog/western-balkan-economic-integration-with-the-eu-time-for-more-ambition/>
- Institute for Public Policy and Good Governance (IPPM), 2015: Economic relations between the Western Balkans Six Countries, Minsitria e Punëve të Jashtme e Shqipërisë. URL: [file:///C:/Users/l-sule/Downloads/Policy_Papers_All-ilove-pdf-compressed%20\(2\).pdf](file:///C:/Users/l-sule/Downloads/Policy_Papers_All-ilove-pdf-compressed%20(2).pdf)
- nstituti i Statistikave, 2022. URL: <http://www.instat.gov.al/>
- International Labor Organization, 2022. URL: <https://www.ilo.org/global/lang--en/index.htm>
- Kajosevic, S., 2022: Montenegro's New PM Supports 'Open Balkan' Initiative, Balkan Insight. URL: <https://balkaninsight.com/2022/05/11/montenegro-new-pm-supports-open-balkan-initiative/>
- Komisioni Evropian REA, 2021: Western Balkans: Regional Economic Area. URL: https://ec.europa.eu/commission/presscorner/detail/hr/MEMO_17_1967
- Komisioni Evropian, 2022: Commissioner Várhelyi participate in the Open Balkan Summit on 8 June. URL: https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/news/commissioner-varhelyi-travels-north-macedonia-participate-open-balkan-summit-8-june-2022-06-07_en
- Komisioni Evropian CRM, 2021: The Western Balkans Common Regional Market – a catalyst for deeper regional economic integration and a steppingstone towards EU Single Market. URL: https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/enlargement-policy/policy-highlights/common-regional-market_en
- Krugman, P., 1991: Geography and Trade. Cambridge, MA: MIT Press
- Levitin, O., 2018: Regional cooperation in the Western Balkans, European Bank for Reconstruction and Development. URL: [file:///C:/Users/l-sule/Downloads/western-balkans-summit-paper%20\(1\).pdf](file:///C:/Users/l-sule/Downloads/western-balkans-summit-paper%20(1).pdf)
- Ligji nr. 92/2014 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë"
- Metodijeski, D., et al 2014: Tourism policy of Balkan countries: Review of national tourism development strategies. UTMS Journal of Economics.
- Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, 2022: Këshillimi Kombëtar, Ministrja Xhaçka: 59% e shqiptarëve mbështesin Ballkanin e Hapur. URL: <https://www.punetejashtme.gov.al/keshillimi-kombetar-ministrja-xhacka-59-e-shqiptareve-mbeshtesin-ballkanin-e-hapur/>
- OECD, 2018: Competitiveness in Southeast Europe: A Policy Outlook
- PWC, 2022: Worldwide Tax Summaries. URL: <https://taxsummaries.pwc.com/albania/individual/other-taxes>
- Ristic, D., 2021: Open Balkan Initiative: Less History, More Business, European Policy Center. URL: <https://cep.org.rs/en/blogs/open-balkan-initiative/>
- Samiti i Ohrit, 2022: Open Balkan Summit in Ohrid Opening sessions (MK). URL: <https://www.youtube.com/watch?v=P72oprTx4XQ>
- State Statistical Office of the Republic of Macedonia, 2022. URL: https://www.stat.gov.mk/Default_en.aspx
- Statistical Office of Montenegro, 2022. URL: <https://www.monstat.org/eng/>
- Statistical Office of the Republic of Serbia, 2022. URL: <https://www.stat.gov.rs>
- The Observatory of Economic Complexity, 2022. URL: <https://oec.world/>
- United Nation World Tourism Organization, 2022. URL: <https://www.unwto.org/>

- United Nations Conference on Trade and Development, 2022. URL: <https://unctad.org/>
- Uvalic, M., 2020: The Idea of Balkan Regional Economic Integration, European Institute of Mediterranean. URL: <https://www.iemed.org/publication/the-idea-of-balkan-region>
- al-economic-integration/
- World Economic Forum, 2020: This is how the Western Balkans will become more innovative. URL: <https://www.weforum.org/agenda/2020/02/western-balkans-become-more-innovative/>



Fondazioni Qemal Stafa

www.fqs.al
secretary@fqs.al